

## **Bashkimi Evropian**

# **Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut Kosovë**

## **Raport vjetor**

**1 janar - 31 dhjetor 2016**

**Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut – Sekretariati**

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 78 2125

Email: [office@hrrp.eu](mailto:office@hrrp.eu)

[www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu)

## Parathënie

Ky është raporti vjetor i shtatë i përgatitur nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) për periudhën 1 janar 2016 deri 31 dhjetor 2016. Ky raport përmban informata rreth zhvillimeve në praktikën gjyqësore të Panelit. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Paneli ka mbajtur tre seanca dhe është angazhuar në takime të jashtme dhe aktivitete me fushata informuese. Vlen të theksohet se pavarësisht mandatit ekzekutiv të kufizuar të Misionit, gjatë tërë vitit ka vazhduar fluksi i rasteve të reja të paraqitura pranë Panelit.

Paneli ka nxjerrë vendime dhe rekomandime të rëndësishme në lidhje me “zhdukjet me forcë” të cilat kanë ndodhur gjatë konfliktit të armatosur në periudhën 1999-2000. Ato vendime dhe rekomandime dolën pas shqyrtimit të ankesave me pretendime për hetime joadekuate nga ana e Misionit EULEX-i Kosovë të rasteve të rrëmbimeve, zhdukjeve, dhe vrasjeve. Rastet ndërlidheshin me pretendime për shkelje të obligimeve procedurale që dalin nga neni 2 (e drejta për jetë) dhe neni 3 (ndalimi i torturës dhe i trajtimit çnjerëzor apo poshtëruar) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa).

Përmes opinioneve të dhëna, Paneli zgjeroi më tej praktikën e tij gjyqësore, posaçërisht në lidhje me disa çështje të reja që u ngritën në disa prej rasteve. Jurisprudenca e tij në rritje e sipër u konsolidua me konsideratë të duhur ndaj standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç parashihet në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) dhe organet e tjera ndërkombëtare, përfshirë Komisionin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.

Pamundësia e Panelit që pas konstatimit të ndonjë shkeljeje të rekomandojë kompensim për viktimat, paraparë me kornizën ligjore fillestare me të cilën është krijuar Paneli në vitin 2008 (shih kapitujt 2.1 dhe 1.2 më poshtë), vazhdon të jetë çështje problematike. Shpesh ndodhë që palët ankuese në mënyrë specifike të kërkojnë kompensime në rastet e personave të zhdukur, (*si rasti Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, lënda nr. 2014-34, vendimi për pranueshmëri, 29 shtator 2015). Ndonëse viktimat marrin një lloj ngushëllimi prej faktit se pretendimet e tyre për shkelje arsyetohen nga Paneli, kjo gjë është dukshëm joadekuate në vetvete. Gjendja përkeqësohet nga fakti se rekomandimet e Panelit për të kërkuar falje apo për të pranuar shkeljen nuk përcillen nga Misioni.

Megjithatë, gjatë periudhës raportuese, Shefi i Misionit EULEX-i Kosovë dhe stafi i tij kanë vazhduar bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me Panelin. Këtu përfshihet dhënia me kohë e përgjigjeve apo e vërejtjeve në lidhje me rastet që i janë paraqitur Misionit. Paneli në veçanti mirëpret sigurimin e dokumenteve që ndërlidhen me thelbin e rastit nën shqyrtim, përfshirë raportet e policisë dhe materialet e tjera që ndërlidhen me hetimet e personave të vvarë apo të pagjetur.

Dua ta shfrytëzoj këtë rast dhe të falënderoj shefen e Misionit për bashkëpunimin e dhënë drejt zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vendimet e Panelit.

Në vitin 2016 Paneli vazhdoi me praktikën e takimit të zyrtarëve të lartë të EULEX-it, zyrtarëve të Bashkimit Evropian, dhe zyrtarëve të tjerë. Përfaqësues nga Paneli po ashtu kanë takuar Përfaqësuesen Speciale të Bashkimit Evropian në Selinë e PSBE më 17 tetor 2016.

Më 28 shtator 2016, ndër të tjerë, në Bruksel jam takuar edhe me Kryesuesin e Komisionit për Kapacitetet për Planifikim dhe Operime Civile (KomCiv/CivCom); Shërbimin e Jashtëm Evropian për Veprime (EEAS), Zëvendëskomandantin e operacioneve civile /Shefin e kabinetit, Zyrtarin

përgjegjës të KomCiv për Kosovën si dhe përfaqësuesit e shteteve anëtare të grupit punues të Komisionit Civil, në Bruksel

Në vitin 2016, Paneli humbi shërbimet e anëtares së tij që i ka shërbyer gjatë, znj. Katja Dominik, dhe të dy zyrtarëve ligjorë dhe një asistenti administrativ. Zvogëlimi i numrit të stafit përmes procesit të rikonfigurimit i shkaktoi Panelit probleme të mëdha sa i përket vazhdimësisë së punës, meqë pati ulje të dukshme të kapaciteteve për përpunimin e rasteve si dhe ngërtheu humbje të kujtesës institucionale.

Dëshiroj të shprehë mirënjohjen time për znj. Katja Dominik, e cila dha dorëheqje më 14 qershor 2016 si anëtare e Misionit EULEX-i Kosovë në Panel. E falënderoj znj. Dominik për kontributin profesional të jashtëzakonshëm në punën e Panelit gjatë katër viteve të përkushtimit të saj dhe i uroj suksese në detyrën e re si Udhëheqëse e Divizionit Ekzekutiv, EULEX.

Dëshiroj të falënderoj znj. Elka Ermenkova, gjyqtare e rasteve penale në Gjykatën Supreme/të Apelit, në Prishtinë, si dhe Misionin EULEX-i Kosovë, për caktimin e saj si anëtare e Misionit EULEX-i Kosovë në Panel më 14 tetor 2016. Po ashtu përgëzoj znj. Anna Bednarek, gjykatëse e Apelit, Kolegji i ankesave i Agjencinë Kosovare të Pronës në Prishtinë, e cila më 14 tetor 2016 u emërua anëtare zëvendësuese e Misionit EULEX-i Kosovë në Panel.

Me këtë rast i uroj mirëseardhje edhe zyrtares sonë të re ligjore znj. Noora Aarnio, e cila më parë ka qenë zyrtare ligjore në Gjykatën e Apelit/Gjykatën Supreme të Kosovës, dhe t'i uroj sukses në pozitën në Panel.

Zyrtarët ligjorë të Panelit Paul Landers dhe Joanna Marszalik, dhe asistentja administrative/gjuhësore Shpresa Gosalci, përfunduan detyrat e tyre në Panel më 16 gusht, përkatësisht më 30 shtator dhe 14 nëntor. Unë po ashtu e shfrytëzoj rastin t'i falënderoj me sinqeritetin më të lartë për kontributin e tyre për punën e Panelit dhe t'iu uroj suksese të mëtejme në karrierë.

Magda Mierzevska  
Anëtare kryesuese  
Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

## Tabela e përmbajtjes

Parathënie.....	2
1. Hyrje.....	5
2. Korniza rregullative.....	6
2.1. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit EULEX-i Kosovë.....	6
2.2. Koncepti i llogaridhënies i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009.....	6
2.3. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.....	7
3. Numri i rasteve dhe lënda e ankesave.....	7
3.1. Numri i rasteve dhe statistikat.....	7
3.2. Trendet.....	8
3.3. Lënda e ankesave.....	8
4. Jurisprudenca.....	10
4.1. Hyrje.....	10
4.2. Historiku.....	10
4.3. Vendimet mbi bazat meritore.....	13
4.4. Vendimet për pranueshmërinë.....	20
4.5. Vendimet për zbatimin e rekomandimeve të Panelit.....	35
5. Aktivitetet e Panelit.....	37
5.1. Takimet e Panelit.....	37
5.2. Fushata informuese e vitit 2016.....	38
5.3. Trajnimi hyrës.....	39
5.4. Faqja e internetit e PSHDNJ.....	39
6. Paneli dhe Sekretariati.....	39
6.1. Anëtarët e Panelit.....	39
6.2. Sekretariati.....	42
6.3. Ish-personeli i Panelit dhe Sekretariatit.....	43
7. Çështjet operative dhe administrative.....	45
7.1. Buxheti.....	45
7.2. Burimet njerëzore.....	45
8. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut – Përfundimi i mandatit.....	46
9. Përfundimet dhe rekomandimet.....	48
SHTOJCA 1 Tabela e personelit.....	52
SHTOJCA 2 Statistikat 2010 - 2016.....	53
SHTOJCA 3 Vendimet e PSHDNJ-së 2010-2016.....	54
SHTOJCA 4 Orari i fushatës informuese dhe aktivitetet e tjera në vitin 2016.....	60

## 1. Hyrje

Bashkimi Evropian ka themeluar Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (më tutje në tekst: Paneli) me 29 tetor 2009 me mandatin për shqyrtimin e ankesave për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana. Paneli është mekanizmi i parë, dhe deri më tani, i vetmi i këtij lloji për të shqyrtuar ankesa për shkelje të të drejtave të njeriut nga një mision i Politikës së Përbashkët për Siguri dhe Mbrojtje me kompetenca ekzekutive.

Së bashku me Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Paneli është një nga vetëm dy panelet ndërkombëtare që janë mandatuar ndonjëherë për kërkimin e llogaridhënies nga organizata ndërkombëtare të cilat veprojnë me role ekzekutive, në lidhje me pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut. Paneli Këshillëdhënës i UNMIK për të Drejtat e Njeriut e përfundoi mandatin më 30 qershor 2016, çka nënkupton se Paneli tani është i vetmi organ i llogaridhënies për të drejtat e njeriut.

Paneli, në bazë të përvojës deri më sot, ka pasur ndikim mbi përmirësimin e punës dhe menaxhimit të rasteve përmes procedurave, praktikave dhe mekanizmave të përmirësuar gjatë periudhës raportuese. Këtu, mes të tjerash, është përfshirë përdorimi i shtuar i mjeteve elektronike për komunikime më të mira mes Panelit dhe Sekretariatit gjatë intervaleve mes seancave.

Paneli ka vazhduar me fushatën informuese, ku përpjekjet kryesore qenë përqendruar tek shoqatat për personat e pagjetur, OJQ-të aktive në sektorin e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e shoqërisë civile, autoritetet lokale dhe palët e interesit në nivel komunal. Sekretariati po ashtu ka vijuar takime të ndryshme, seminare, konferenca dhe diskutime nëpër tryeza të rrumbullakëta në lidhje me temën e të drejtave të njeriut.

Përkundër përpjekjeve të shumta, dhe aktiviteteve me fushata informuese, sensibilizimi publik rreth mandatit, procedurave dhe operimit të Panelit në fushën e operimit për EULEX-in Kosovë mbetet çështje shqetësuese. Paneli do të përqendrohet në këtë problem në aktivitetet e tij informuese gjatë vitit 2017, ndër të tjera, me vazhdimin e fushatës informuese televizive e cila është zhvilluar me sukses në vitin 2014.

Megjithatë, Paneli vazhdon t'i shtojë vlerë mandatit të Misionit EULEX-it Kosovë, ndër të tjera, përmes sigurimit të mjeteve ligjore domethënëse, mbështetjes dhe ndihmës dhënë qytetarëve në masë të madhe, si dhe përmes dhënies së shembullit të mirë për institucionet e shtetit në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Paneli është shenjë e qartë se Misioni i merr me seriozitet përgjegjësitë e veta për të drejtat e njeriut dhe, duke iu nënshtruar kompetencës së Panelit, jep shembull të mirë të kompetencave, bazuar në llogaridhënien.

Përgjatë vitit 2016, në Panel janë pranuar tridhjetë e gjashtë (36) ankesa të reja dhe janë shqyrtuar gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) lëndë. Paneli ka konstatuar se EULEX-i kishte kryer shkelje të të drejtave të njeriut në nëntë (9) raste. Paneli po ashtu ka konstatuar se nëntë (9) raste nuk kanë qenë të pranueshme dhe ka hequr nga lista një (1) rast.

Shkeljet e të drejtave që i atribuohen Misionit kishin të bënin me hetime joadekuate në lëndët nr. 2014-11 deri 2014-17, D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S. dhe I.R. kundër EULEX-it, si dhe në lëndën nr. 2014-34 Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it.

Në ato tetë raste, Paneli ka konstatuar se EULEX-i Kosovë i ka shkelur të drejtat e palëve ankuese të garantuara me nenin 2 – E drejta për jetë, nenin 3 - Ndalimi i torturës dhe i trajtimit çnjerëzor apo degradues, si dhe nenin 13 - E drejta për mjete efektive në lidhje me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në lëndën nr. 2014-37 Y.B. kundër EULEX-it, Paneli ka konstatuar se EULEX-i i ka shkelur të drejtat e palës ankuese të garantuara me nenin 8 - E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare. Paneli ka konstatuar tetë raste si të papranueshme në bazë të rregullave 25 (1); 25 (3) dhe 29, të Rregullores së Punës.

Paneli, duke vepruar sipas rregullit 34 dhe rregullit 45 *bis* të Rregullores së Punës, i ka dhënë rekomandime korigjuese të hollësishme Shefit të Misionit EULEX-i Kosovë në lidhje me shkeljet që i kishte konstatuar dhe e ka bërë vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve nga Shefi i Misionit në vendimet pasuese.

## **2. Korniza rregullative**

### **2.1. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit EULEX-i Kosovë**

Veprimi i përbashkët i Këshillit është burimi i autoritetit dhe i kompetencave të Misionit EULEX-i Kosovë. Në atë veprim përcaktohet *mandati* i EULEX-it Kosovë dhe, *ndër të tjera*, specifikohet përgjegjësia e tij për të vepruar në përputhje me standardet përkatëse për të drejtat e njeriut, neni 3 (i): *“të sigurojë që të gjitha aktivitetet e tij t’i respektojnë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe përfshirjen gjinore”*.

### **2.2. Koncepti i llogaridhënies i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009**

Themelimi i një mekanizmi të pavarur, efektiv dhe transparent për llogaridhënie në lidhje me të drejtat e njeriut ishte konsideruar të jetë kriter themelor për EULEX-in Kosovë si mision për sundim të ligjit me disa funksione ekzekutive të kufizuara. Ky mekanizëm i jashtëm i llogaridhënies kishte për qëllim plotësimin e llogaridhënies së përgjithshme të Misionit EULEX-i Kosovë siç parashihet me Skemën e Sigurimit të Përgjegjësive për Palën e Tretë dhe Mekanizmin e Brendshëm Disiplinor të EULEX-it.

Andaj, Koncepti i llogaridhënies përcaktoi *mandatin* e Panelit që: *të shqyrtojë ankesa nga çdo person, që nuk është pjesë e personelit të EULEX-it Kosovë, që pretendon të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë*.<sup>1</sup>

Megjithatë, sipas Konceptit të llogaridhënies, Paneli nuk ka juridiksion në lidhje me gjykatat e Kosovës. Fakti se gjyqtarët e EULEX-it janë anëtarë të trupave gjyqes të ndonjë gjykate të caktuar nuk e ndryshon natyrën e këtyre gjykatave si gjykata të Kosovës, (fusnota & jurisprudenca).

---

<sup>1</sup> Koncepti i llogaridhënies është pjesë e planit operacional të EULEX-it. Ai është dokument i kufizuar dhe nuk është i qashtëm për publikun. Paneli nuk e ka lirinë për zbulimin e detajeve që përmbahen aty.

Paneli e ka miratuar rregulloren e punës më 10 qershor 2010, nga e cila datë Paneli është autorizuar të pranojë ankesa. Paneli i ka ndryshuar rregullat e veta më 21 nëntor 2011 dhe 15 janar 2013.

### 2.3. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Në pajtim me dispozitat e Konceptit të llogaridhënies, Paneli mund të shqyrtojë ankesa në lidhje me pretendime të shkeljeve të, mes të tjerave, instrumenteve të të drejtave të njeriut si në vijim:


- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa, 1950)
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD, 1965)
- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (CCPR, 1966)
- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR, 1966)
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Femrave (CEDAW, 1979)
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit tjetër Misor, Çnjerëzor apo Degradues (CAT, 1984)
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës (CRC, 1989)


Në praktikë, ankesat që janë paraqitur deri më sot kryesisht janë thirrur në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj. Një numër i ankesave po ashtu janë thirrur në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, marrëveshjet ndërkombëtare dhe instrumentet e tjera për të drejtat e njeriut.

## 3. Numri i rasteve dhe lënda e ankesave

### 3.1. Numri i rasteve dhe statistikave

Në vitin 2016, Paneli ka regjistruar tridhjetë e gjashtë (36) ankesa të reja dhe i ka shqyrtuar nëntëmbëdhjetë (19) raste. Paneli konstatoi se EULEX-i kishte kryer shkelje të të drejtave të njeriut në nëntë (9) raste. Paneli po ashtu konstatoi se nëntë (9) raste nuk ishin të pranueshme dhe hoqi nga lista një (1) rast.





### 3.2. Trendet

Shumica e ankesave të paraqitura kundër EULEX-it në vitin 2016 kishin të bënin me pretendime për mungesë të hetimeve të duhura nga prokuroria e EULEX-it apo për refuzim të nisjes së hetimeve për raste të vrasjeve dhe personave të pagjetur, pra raste të “zhdukjeve me forcë”.

Paneli zbatoi standardet përkatëse të të drejtave të njeriut në lidhje me rastet e “zhdukjeve me forcë” në kontekstin specifik të misionit për sundimin e ligjit, dhe vlerësoi se si, në rrethana specifike si këto, obligimet aktuale të shtetit (në veçanti sa i përket hetimit të rasteve të tilla) mund të barten tek një situatë ku është i përfshirë ndonjë mision për sundimin e ligjit.

Mund të theksohet se, në kontekstin e rasteve të “zhdukjeve me forcë”, statusi i “viktimës” për qëllime të procedurave para Panelit në këto rrethana nuk është kufizuar vetëm tek “personi i zhdukur”. Termi “viktimë” po ashtu është interpretuar për të përfshirë familjarët e afërt të personit të vrarë apo të pagjetur, të cilët vuajnë pafund prej traumave të vazhdueshme nga mosdija e fatit dhe/apo nga pamundësia e gjetjes së fatit të familjarëve të tyre.

Paneli ka vazhduar me rafinimin e qasjes së vet ndaj zbatimit të standardeve për të drejtat e njeriut ndaj një misioni për sundim të ligjit, dhe i ka përkufizuar disa prej kufijve të asaj detyre. Ndonëse EULEX-i Kosovë, si mision për sundim të ligjit, natyrisht se nuk është shtet, Paneli ka theksuar se mandati i tij kërkon në parim respektimin e rreptë të standardeve themelore për të drejtat e njeriut nga ana e tij.

### 3.3. Lënda e ankesave

Llojet më të zakonshme të ankesave me pretendime për shkelje të të drejtave të njeriut të cilat janë shqyrtuar nga Paneli në vitin 2016 ishin si në vijim:

- Pretendime për shkeljen e së drejtës për jetë (neni 2 i Konventës; neni 6 i Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike); rastet e [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11 deri 2014-17; [L.O. kundër EULEX-it](#) nr. 2014-32; [Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#) nr. 2014-34; [Mustafa-Sadiku kundër EULEX-it](#), nr. 2014-41;



- Pretendime për shkeljen e së drejtës për ndalimin e torturës, trajtimin çnjerëzor apo degradues (neni 3 i Konventës; neni 7 i Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike; neni 6 par. 1 dhe 2 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo degraduese): rastet [Stanisić kundër EULEX-it](#), nr. 2012-22; [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K deri T\) kundër EULEX-it](#), nr. 2013-05 to 2013-14; të [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11 deri 2014-17; [L.O. kundër EULEX-it](#) nr. 2014-32; [Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#) nr. 2014-34; [Mustafa-Sadiku kundër EULEX-it](#), nr. 2014-41;
- Pretendime për shkeljen e së drejtës për liri dhe siguri (neni 5, par. 1c, 2, 3 dhe 4 të Konventës; neni 9, par. 2 deri 4 të Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike): rastet [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K deri T\) kundër EULEX-it](#), nr. 2013-05 deri 2013-14; [Krasniji kundër EULEX-it](#), nr. 2014-33;
- Pretendime për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe qasje në gjykatë (neni 6 i Konventës; neni 14 i Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike): rastet [X dhe 115 ankuesit e tjerë kundër EULEX-it](#), nr. 2011-20; [Radunović kundër EULEX-it](#) nr. 2014-02; [Ibrahimi kundër EULEX-it](#) nr. 2014-05; [Maksutaj kundër EULEX-it](#) nr. 2014-18; [J.Q. kundër EULEX-it](#) nr. 2014-24; [Kaçiu kundër EULEX-it](#) nr. 2014-26; [Shabani kundër EULEX-it](#) nr. 2014-30; [K.P. kundër EULEX-it](#) nr. 2014-31; [Mikić kundër EULEX-it](#) nr. 2014-38; [Hajdari kundër EULEX-it](#) nr. 2014-40;
- Pretendime për shkeljen e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 i Konventës; neni 17 i Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike): rastet [Stanisić kundër EULEX-it](#), nr. 2012-22; [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11-2014-17; [L.O. kundër EULEX-it](#) nr. 2014-32; [Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#) nr. 2014-34; [Y.B. kundër EULEX-it nr. 2014-37](#);
- Pretendime për shkeljen e së drejtës për lirinë e të menduarit, ndërgjegjes dhe fesë (neni 9 i Konventës; neni 18 i Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike): rastet [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K deri T\) kundër EULEX-it](#), nr. 2013-05 to 2013-14;
- Pretendime për shkeljen e së drejtës për mjete juridike efektive (neni 13 i Konventës) në lidhje me
  - Neni 6: [X dhe 115 ankuesit e tjerë kundër EULEX-it](#), nr. 2011-20; [Radunović kundër EULEX-it](#), nr. 2014-02; [Ibrahimi kundër EULEX-it](#) nr. 2014-05
  - Neni 8: [Stanisić kundër EULEX-it](#), nr. 2012-22; [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11 to 2014-17; [L.O. kundër EULEX-it](#) nr. 2014-32; [Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#) nr. 2014-34;
- Pretendime për shkeljen e së drejtës për trajtim të barabartë (neni 14 i Konventës; neni 26 i Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike): [Stanisić kundër EULEX-it](#), nr. 2012-22; [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K to T\) kundër EULEX-it](#), nr. 2013-05 deri 2013-14; [Radunović kundër EULEX-it](#) nr. 2014-02; [Ibrahimi kundër EULEX-it](#) nr. 2014-05;
- Pretendime për shkeljen e së drejtës për gëzimin paqësor të posedimeve vetanake (neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës): [Begolli kundër EULEX-it](#) nr. 2014-27; [Musa kundër EULEX-it](#), nr. 2014-29; [Zherka kundër EULEX-it](#) nr. 2014-42.

Një numër i ankuesve iu kanë referuar, në mënyrë të përgjithësuar, instrumenteve të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

## **4. Jurisprudenca**

### **4.1. Hyrje**

Paneli ka nxjerrë një sërë vendimesh të rëndësishme për lëndë me ankesa për mungesë të hetimeve të duhura penale për raste të zhdukjeve, rrëmbimeve dhe vrasjeve, në pajtim me obligimet procedurale të parapara me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa), dhe ankesa për shkeljen e nenit 3 të Konventës në lidhje me trajtimin çnjerëzor dhe degradues të familjarëve dhe lidhjeve të tjera të afërta familjare të viktimave.

Këto ankesa paraqitën disa çështje të reja të pashqyrtuara deri tani në jurisprudencën e Panelit. Përmes këtij zgjerimi, ankesat përfshinë rrethana dhe çështje të cilat nuk ishin hasur më parë nga mekanizmat ndërkombëtarë për llogaridhënie në lidhje me të drejtat e njeriut, siç është Paneli. Me qëllim të trajtimit të atyre ankesave, Paneli kreu një shqyrtim të gjerë të praktikës gjyqësore të organeve të tjera për të drejtat e njeriut dhe e zbatoi atë për rrethanat karakteristike të Misionit.

Në shumicën e rasteve, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përbënë bazën primare për arsyetimin dhe vendimet e dhëna nga Paneli. Kjo jurisprudencë e zhvilluar mund të konsiderohet kontribut thelbësor i Panelit për zhvillimin e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Shumica e ankesat të dorëzuara në Panel gjatë vitit 2016 po ashtu kishin të bënin me çështje të ngjashme të “zhdukjeve me forcë” dhe Paneli do të vazhdojë me zhvillimin e mëtejshëm të jurisprudencës së vet gjatë shqyrtimit të këtyre rasteve në vitin 2017.

### **4.2. Historiku**

Rastet e personave të pagjetur dhe personave të vrarë, pra rastet e “zhdukjeve me forcë”, të shqyrtuara në këtë pjesë të raportit, ndodhën si rezultat i konfliktit të armatosur në Kosovë në vitin 1999, në veçanti, në periudhën menjëherë pas themelimit të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) më 10 qershor 1999.

Konflikti i armatosur që u zhvillua mes forcave serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) si dhe grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës ishte i dokumentuar mirë në atë kohë. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit Veri-Atlantik (NATO) shpalli fillimin e sulmeve ajrore kundër Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ) më 23 mars 1999, pas dështimit të ndërmjetësuesve ndërkombëtarë për zgjidhjen e konfliktit.

Sulmet ajrore nga NATO filluan më 24 mars 1999 dhe përfunduan më 8 qershor 1999, kur RFJ u pajtua t'i tërheqë forcat nga Kosova. Më 9 qershor 1999, Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (KFOR) dhe RFJ nënshkruan një “Marrëveshje teknike ushtarake” me të cilën u pajtuan për tërheqjen e RFJ nga Kosova dhe vendosjen e një force ndërkombëtare të sigurisë. Rezoluta mundësuese e Këshillit të Sigurimit të OKB 1244 u miratua më 10 qershor 1999.

## **Kapitulli VII i Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara**

Duke vepruar në pajtim me Kapitullin VII të Kartës së OKB-së, përdorimi i forcës, Këshilli i Sigurimit i OKB-së vendosi që në Kosovë të vendosë një prani ndërkombëtare civile dhe të sigurisë e përbërë prej KFOR-it dhe UNMIK-ut.

Në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit, UNMIK-ut iu dhanë kompetenca të plota legislative dhe ekzekutive për administrimin e përkohshëm civil të Kosovës, çka përfshiu edhe administrimin e drejtësisë.

KFOR-it iu dha detyra e krijimit të “mjedisit të sigurt në të cilin do të mund të ktheheshin pa rrezik refugjatët dhe personat” dhe sigurimit të përkohshëm “të sigurisë dhe rendit publik” deri në marrjen e përgjegjësive nga komponenta e policisë civile ndërkombëtare.

UNMIK-u përbëhej prej katër komponentave kyçe të udhëhequra nga Organizata e Kombeve të Bashkuara - administrata civile, Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët - ndihmë humanitare, i mbyllur në qershor 2000, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) - ndërtimi i institucioneve, dhe Bashkimi Evropian (BE) - rindërtim dhe zhvillim ekonomik.

Secila shtyllë ishte e vendosur nën autoritetet e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, (PSSP). Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ndër të tjera, e autorizoi UNMIK-un që “t’i promovojë dhe t’i mbrojë të drejtat e njeriut” në Kosovë në pajtim me standardet ndërkombëtarisht të pranuar për të drejtat e njeriut.

### **Personat e zhvendosur përbrenda**

Vlerësohet se mes 800,000 dhe 1.45 milionë shqiptarë të Kosovës u zhvendosën gjatë konfliktit të armatosur. Pas miratimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit, shumica e shqiptarëve të Kosovës që kishin ikur nga vendi, apo që ishin dëbuar me forcë nga forcat serbe, u kthyen në Kosovë.

Ndërkohë, serbët, romët dhe boshnjakët, si dhe shqiptarët e Kosovës të dyshuar për bashkëpunim me autoritetet serbe, ishin sulmuar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe grupe të armatosura të shqiptarëve të Kosovës. Numri i përafërt i serbëve të Kosovës të zhvendosur sillel prej 200,000 deri 210,000. Derisa shumica e serbëve të Kosovës dhe personave të tjerë jo-shqiptarë ikën për në Serbi dhe shtetet fqinje, ata serbë që qëndruan në Kosovë pretendohet se qenë viktime të vrasjeve, rrëmbimeve, paraburgimeve arbitrare, dhunës seksuale dhe të bazuar në gjini, rrahjes, dhe ngacmimeve sistematike.

Vlerësohet se më shumë se 15,000 vrasje apo zhdukje ndodhën gjatë dhe menjëherë pas konfliktit të armatosur nga viti 1998 deri në fund të vitit 2000. Më shumë se 3000 shqiptarë etnikë, dhe rreth 800 serbë, romë dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera pakicë u zhdukën gjatë kësaj periudhe. Deri në fund të vitit 2010 më shumë se gjysma e personave të zhdukur u gjetën dhe mbetjet e tyre mortore u identifikuan. Megjithatë, deri në maj të vitit 2015 në listën e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC) figurojnë rreth 1653 persona që ende konsiderohen si të pagjetur.

### **Vendosja e UNMIK-ut**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në UNMIK (PSSP) u bëri thirrje shteteve anëtare të OKB-së që të mbështetnin vendosjen e komponentës së UNMIK-ut për administratën civile, ndër të tjera, për rikthimin e ligjit dhe rendit në korrik 1999. Kjo përfshiu një forcë policore ndërkombëtare e cila kishte për detyrë t’i jepte këshilla KFOR-it në lidhje me çështje të policisë deri kur ata të kishin burime të mjaftueshme për marrjen përsipër të përgjegjësisë për zbatimin e ligjit.

Shtrirja e komponentës së policisë së UNMIK-ut pothuajse u kompletua deri në dhjetor 2000, me vendosjen e rreth 4400 punonjësve, dhe në këtë pikë UNMIK-u morri përsipër përgjegjësitë për ligj dhe rend në Kosovë, me përjashtim të rajonit të Mitrovicës. Policia e UNMIK-ut, deri diku e papërvajë në rolin e policisë në situata pas konfliktit, u konfrontua me një shkallë të lartë të krimit që sipas raportimeve përfshiu 351 kidnapime, 675 vrasje dhe 115 dhunime seksuale nga qershori 1999 deri në dhjetor 2000.

Sa i përket drejtësisë, në qershor 1999 UNMIK-u e themeloi sistemin e drejtësisë emergjente për t'u marrë me boshllëkun e rendit dhe ligjit. Ky sistem përbëhej prej një numri të vogël të gjyqtarëve dhe prokurorëve vendas dhe punoi deri në themelimin e sistemit të rregullt të drejtësisë në janar të vitit 2000. Në shkurt të vitit 2000, UNMIK-u autorizoi caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, fillimisht në rajonin e Mitrovicës, dhe pastaj nëpër tërë Kosovën. Në tetor 2002, sistemi vendas i drejtësisë përbëhej prej 341 gjyqtarëve dhe prokurorëve vendas dhe 24 gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë.

### **Personat e pagjetur**

Në lidhje me personat e pagjetur, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së raportoi në Këshillin e Sigurimit se UNMIK-u qysh në korrik 1999 e konsideronte çështjen e personave të pagjetur si shqetësim akut për të drejtat e njeriut. Si rezultat, brenda Policisë së UNMIK-ut u themelua Njësia për Personat e Pagjetur (NjPP), e cila në nëntor 1999 u mandatua për hetimin e lokacioneve dhe/apo varrezave të mundshme të personave të pagjetur. NjPP, së bashku me Njësinë Qendrore për Hetime Penale (NjQHP), Policinë e UNMIK-ut, dhe më vonë Njësinë e dedikuar për Hetimin e Krimeve të Luftës (NjHKL), ishin përgjegjëse për zhvillimin e hetimeve për rastet e personave të pagjetur.

Në maj të vitit 2000 u themelua Komisioni për Gjetjen dhe Identifikimin e Viktimave për gjetjen dhe identifikimin e mbetjeve mortore të viktimave dhe Zyra për të Burgosurit dhe Personat e Pagjetur (ZBPP) u themelua brenda Zyrës së PSSP-së me përgjegjësi për centralizimin e informatave rreth personave të pagjetur.

Më 5 nëntor 2001, UNMIK-u nënshkroi Dokumentin e përbashkët mes UNMIK-ut/Republikës Federative të Jugosllavisë i cili ritheksoi, mes të tjerash, zotimin e tij për gjetjen e fatit të personave të pagjetur nga të gjitha komunitetet, dhe pranoi se programi i zhvarrimeve dhe identifikimeve ishte vetëm një nga iniciativat që ndërldheshin me personat e pagjetur.

Në qershor 2002, Zyra e re për Personat e Pagjetur dhe Mjekësinë Ligjore (ZPPML) në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut u bë autoriteti i vetëm me mandat për përcaktimin e lokacioneve të personave të pagjetur, identifikimin e mbetjeve të tyre mortore dhe kthimin e tyre tek familjarët. Të gjitha informatat të grumbulluara nga ZBPP u transferuan tek ZPPML.

### **Themelimi i Misionit EULEX-i Kosovë**

Më 9 dhjetor 2008, mandati ekzekutiv i UNMIK-ut u transferua tek EULEX-i Kosovë. Ky dorëzim i kompetencave ekzekutive pasoi pas një Deklarate nga Presidenti i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), e cila, mes të tjerash, mirëpriti angazhimin e vazhduar të Bashkimit Evropian në Kosovë.

Po në atë datë, UNMIK-u dhe EULEX-i Kosovë nënshkruan një memorandum të mirëkuptimit për modalitetet dhe të drejtat dhe obligimet përkatëse që dolën nga bartja e autoritetit ekzekutiv nga UNMIK-u tek EULEX-i për lëndët e UNMIK-ut dhe dosjeve të tjera të lëndëve. Këto lëndë përfshinë

hetimet dhe ndjekjet penale në vazhdim e sipër të cilat deri në atë kohë ishin zhvilluar nga prokurorë ndërkombëtarë të UNMIK-ut.

Pas një kohe të shkurtë u nënshkruan edhe marrëveshje të ngjashme në lidhje me dosjet që ishin trajtuar nga gjyqtarë ndërkombëtarë të UNMIK-ut dhe policia e UNMIK-ut. Me këto marrëveshje UNMIK-u u obligua që EULEX-it t'i ofrojë qasje në dokumentet në lidhje me veprimet që ishin ndërmarrë në të kaluarën nga policia e UNMIK-ut dhe komponenti i drejtësisë. Të gjitha lëndët e rasteve penale që mbaheshin nga Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut dhe nga Policia e UNMIK-ut duhej t'i dorëzoheshin EULEX-it mes periudhës 9 dhjetor 2008 dhe 30 mars 2009.

### **4.3. Vendimet mbi bazat meritore**

#### **Personat e vrarë dhe personat e pagjetur – zhdukjet me forcë**

**Rastet nr. 2014-11 deri 2014-17, [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S. dhe I.R., përkatësisht, kundër EULEX-it](#)**

Shtatë (7) ankesat për këto raste kanë të bëjnë me vrasjet e personave të përkatësisë etnike serbe që kanë ndodhur në Kosovë gjatë periudhës 16 qershor 1999 deri 11 mars 2000. Duke pasur parasysh ngjashmëritë e konsiderueshme mes çështjeve të ngritura në ankesa, Paneli vendosi të urdhëroi bashkimin formal të rasteve në pajtim me rregullën 20 të Rregullores së punës të Panelit.

Palët ankuese janë përfaqësuar nga znj. Jovanka Stojavljevic-Savic, Savic & Co Solicitors, 39 Warren Street, Londër W1T 6AF.

Shefi i Misionit, në vërejtjet e tij sa i përket bazës meritore të rasteve, iu përgjigj pyetjeve të Panelit se a do të kishin pasur prokurorët e EULEX-it kompetencë për ndjekjen penale të rasteve në pajtim me “rrethanat e jashtëzakonshme” nga neni 7(A) i ligjit të ndryshuar për juridiksionin, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, i datës 23 prill 2014.

#### **Faktorët e marrë parasysh për përcaktimin e “rrethanave të jashtëzakonshme”**

Në vendimin rreth bazës meritore të ankesave, në lidhje me ligjin e aplikueshëm, Paneli ka theksuar se faktorët në vijim, ndër të tjerë, do të aplikoheshin për vlerësimin e fakteve relevante të rastit për të përcaktuar atë që përbënë “rrethana të jashtëzakonshme”:

Së pari, Paneli duhet të përcaktojë nëse rasti është hetuar në mënyrë efektive deri atë kohë. Përgjigja negative do të ishte në favor të prokurorëve të EULEX-it që ushtronin kompetenca “të jashtëzakonshme”. Paneli përcaktoi se rastet që ishin temë e ankesave nuk kishin qenë pjesë e hetimeve të plota dhe efektive nga asnjë entitet, dhe gjatë asnjë periudhe të konsiderueshme.

Së dyti, Paneli ishte i mendimit se duhej kushtuar rëndësi e duhur pyetjes nëse çështjet për të cilat janë paraqitur ankesa kanë të bëjnë me të drejtat themelore të rëndësishme dhe nëse shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut janë jashtëzakonisht të rënda. Këto konstatime prapë do të ishin në favor të përfshirjes “së jashtëzakonshme” të prokurorëve të EULEX-it. Në këtë aspekt, të gjitha rastet nën shqyrtim kishin të bënin me të drejta themelore të rëndësishme, përfshirë të drejtën për jetë.

Po ashtu, Paneli ishte i bindur se ekzistonte mundësi e fortë që këto krime dhe shkeljet përkatëse të të drejtave të njeriut ishin ndëretnike apo fetare, çka i drejtohet më tej kompetencës juridiksionale të EULEX-it Kosovë. Paneli theksoi se këto raste duhet të jenë prioritete të qarta hetimore në mjediset pas konflikteve në të cilat raportet ndëretnike dhe fetare mund të jenë të tensionuara dhe të brishta. Paneli doli në përfundim se ky faktor nuk dukej se ishte marrë parasysh prej EULEX-i Kosovë në përcaktimin e tij të “rrethanave të jashtëzakonshme”.

Në fund, Paneli theksoi se nëse prokurorët e EULEX-it vendosën të mos e ushtronin kompetencën e tyre “të jashtëzakonshme” në lidhje me ato raste, atëherë u ngrit pyetja nëse ka ekzistuar mundësi e mirëfilltë dhe e vërtetë që autoritetet kosovare kanë mundur t’i kryenin përgjegjësitë e veta hetimore në lidhje me ato raste. Paneli theksoi se nuk ka pasur asnjë indikacion se do të ishte ashtu apo se veprimet e duhura janë ndërmarrë për t’i gjetur faktet në këtë aspekt.

### **Rekomandimet e Panelit**

Paneli ka rekomanduar që Shefi i Misionit duhet, ndër të tjera, t’i komunikojë vendimet dhe konstatimet tek të gjitha organet relevante hetimore dhe prokuroriale të Misionit EULEX-i Kosovë dhe se ai t’ua theksojë atyre rëndësinë e rasteve të zhdukjeve që vazhdojnë të jenë prioritete hetimor i EULEX-it për të siguruar që këto raste të hetohen plotësisht dhe në mënyrë efektive.

Shefit të Misionit po ashtu iu bë thirrje që autoriteteve kompetente hetimore dhe prokuroriale brenda EULEX-i Kosovë t’ua tërheqë vëmendjen tek faktorët e cekur më lartë si të rëndësishëm për vlerësimin e kompetencës “së jashtëzakonshme” të prokurorëve të EULEX-it nën nenin 7(A) dhe t’ua theksojë rëndësinë e marrjes parasysh të këtyre faktorëve gjatë vlerësimit nga ana e tyre të asaj nëse ata duhet të kërkojnë marrjen e përgjegjësisë për shqyrtimin e atyre rasteve.

Paneli po ashtu ka theksuar se ai ka pritur që këto raste do të shqyrtoheshin në aspektin e parametrave të paraparë me qëllim që të sigurohet që autoritetet hetimore dhe prokuroriale të marrin vendim ligjor dhe të bazuar sa i përket nevojës për t’i hetuar disa apo të gjitha rastet.

### **Vendimi dhe rekomandimet**

Paneli ka konstatuar se përpjekjet hetimore të EULEX-it Kosovë ishin të pamjaftueshme në veçanti duke pasur parasysh peshën e shkeljeve të të drejtave nën shqyrtim dhe se ato kanë rezultuar në shkeljet e të drejtave të ankuesve të garantuara me nenin 2 - E drejta për jetë, nenin 3 - Ndalimi i torturës dhe i trajtimit çnjerëzor apo degradues dhe nenin 13 - E drejta për mjete efektive në lidhje me nenin 2 të Konventës. Paneli gjithashtu ka paraqitur një numër të rekomandimeve para Shefit të Misionit, siç është theksuar më lartë.

### **Lënda nr. 2014-34, [Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#).**

#### **Vendimi për bazën meritore – nenet 2, 3 dhe 13 të Konventës**

Z. Sylë Sadiku, babai i paraqitëses së ankesës, ishte zhdukur më 7 dhjetor 2000 nga banesa e tij në pjesën veriore të Mitrovicës gjatë një sulmi prej një grupi të personave të armatosur, që besohet se kanë qenë të përkatësisë etnike serbe. Dëshmitare e sulmit ka qenë njëra prej motrave të paraqitëses së ankesës, e cila më vonë ishte evakuuar nga trupat e KFOR-it francez. Paraqitësja e ankesës nuk kishte marrë asnjë informatë rreth vendndodhjes së babait të saj që nga koha kur ishte zhdukur.

Paraqitësja e ankesës në këtë rast u përfaqësua nga z. Kushtrim Istrefi, 12 Rue de L'école de Medicine, 1205 Gjenevë, Zvicër.

### **Parashtrirat e palës ankuese**

Ankuesja ka parashtruar se EULEX-i ia kishte shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës për nga ana procedurale e tyre. Në veçanti, ajo ka parashtruar se prokurorët e EULEX-it nuk kishin nisur hetime në pajtim me ligjin e Kosovës dhe mandatin e EULEX-i Kosovë, se EULEX-i kishte vonuar padrejtësisht procesin hetimor dhe referimin e rastit tek prokurorët e Kosovës, e kishte neglizhuar peshën e rastit, lokacionin gjeografik të ndjeshëm të krimit në pjesën veriore të Mitrovicës, karakterin e krimit të luftës dhe karakterin ndëretnik të krimit.

### **Parashtrirat nga Shefi i Misionit**

Në përgjigjen e tij ndaj pyetjes së Panelit nëse prokurorët e EULEX-it do të ishin kompetent për ndjekjen penale të rastit sipas "rrethanave të jashtëzakonshme" nga neni 7(A) të Ligjit të ndryshuar për juridiksionin, Shefi i Misionit theksoi se "rrethanat e jashtëzakonshme" në kuptim të kësaj dispozite ishin përshkruar në Udhëzimin Administrativ të Prokurorisë Speciale të Kosovës në pjesën e përshkrimit dhe caktimit të detyrave dhe mënyrës së bashkëpunimit mes kryeprokurorit të PSRK-së dhe zëvendëskryeprokurorit (nga EULEX-i) të PSRK në pjesën e administrimit dhe menaxhimit të PSRK-së, 5 tetor 2014.

Në pajtueshmëri me nenin 4.4 të udhëzimit administrativ të cekur, këto rrethana të jashtëzakonshme përfshinin: "(mosgatishmërinë apo pamundësinë nga ana e prokurorëve të Kosovës); që ekspertiza dhe përvoja e prokurorit të EULEX-it do të siguronte hetimin dhe ndjekjen penale të duhur të rastit; që të ekzistonte dyshim i bazuar për përpjekje të ndikimit mbi hetimet apo ndjekjen penale; dhe që rasti nën hetim të prekë interesat e shteteve anëtare të BE-së apo të punonjësve të EULEX-it në Kosovë."

Në rastet kur këto kritere përmbusheshin, një kërkesë e hollësishme duhej t'i drejtohej kryeprokurorit të shtetit apo kryeprokurorit të EULEX-it, në të cilën duhej të theksoheshin rrethanat e jashtëzakonshme të pohuara. Vendimi për aplikimin e nenit 7(A) për ndonjë rast të caktuar merrej bashkërisht nga ana e dy prokurorëve dhe nuk ishte përgjegjësi e prokurorit të EULEX-it që vet të vendoste për marrjen përsipër të rastit.

### **Përgjigjet e paraqitëses së ankesës**

Në përgjigjen e saj paraqitësja e ankesës e hodhi poshtë pohimin e Shefit të Misionit se rasti nuk ishte në kuadër të dispozitave të nenit 7(A). Ajo theksoi se prokuroria e Kosovës as nuk ishte e gatshme e as nuk mundte të hetonte raste të zhdukjeve me forcë, siç edhe ishte pranuar në Raportin e Progresit të BE-së për Kosovën, viti 2015. Në anën tjetër, prokuroria e EULEX-it kishte përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të siguruar hetimin dhe ndjekjen penale të duhur të rastit.

Më tej, paraqitësja e ankesës pohoi se natyra e rastit kërkonte që ai të trajtohej sipas nenit 7(A), meqë ai kishte të bënte me "zhdukjen me forcë". Obligimi për hetimin e rasteve të tilla në pajtueshmëri me nenin 7(A) dhe për dënimin e përgjegjësve, si gjatë luftës ashtu edhe gjatë paqes, mori statusin e *jus cogens*. Andaj ishte e rëndësishme që kryerësit të akuzoheshin për "zhdukje me forcë" e jo për ndonjë vepër penale tjetër, si për rrëmbim apo vrasje.

### **Obligimi për të hetuar - EULEX-i Kosovë**

Paneli, gjatë shqyrtimit të bazës meritore të rastit, theksoi se EULEX-i nuk ishte shtet dhe se mundësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohej me atë që do të mund të pritej prej një shteti.

Paneli po ashtu i pranoi vështirësitë që detyrimisht përfshiheshin në hetimin e krimeve të rënda në një shoqëri pas konfliktit, siç është Kosova. Paneli theksoi se situata e tillë mund të ndërlikojë kërkimin e provave, mbrojtjen e dëshmitarëve apo kryerjen e detyrave të caktuara hetimore apo forenzike. Fakti se hetimet apo ndjekja penale janë bërë në një situatë pas konfliktit megjithatë nuk mund të arsyetojë çdo mangësi hetimore përveç nëse ato mangësi me arsye ishin të lidhura me vështirësi të caktuara të ndërlidhura me atë situatë.

Paneli gjithashtu theksoi se nga EULEX-i, si mision për sundim të ligjit, pritej t'i kushtohej vëmendje e veçantë nevojës për rivendosjen, ruajtjen dhe fuqizimin e sundimit të ligjit. "Zhdukja me forcë" njëkohësisht ishte krim i rëndë dhe shkelje e të drejtave të njeriut. Kjo vepër përfshinte një lloj të shumanshëm të shkeljes së të drejtave themelore të njeriut, "në veçanti të drejtës për jetë, liri dhe siguri të personit, të drejtës për të mos iu nënshtuar torturës, të drejtës për liri nga arrestimi apo burgimi arbitrar, dhe të drejtës për gjykim të drejtë dhe publik".

Paneli theksoi se, me kalimin e kohës, ndalimi i "zhdukjeve" filloi të konsiderohej si garancion i pavarur i detyrueshëm për shtetet si çështje e të drejtave themelore të pranuar ndërkombëtarisht. Viktimat e këtyre akteve nuk ishin vetëm të zhdukurit, por mund të ishin edhe familjarët e të zhdukurve, të cilët vuajnë nga trauma emocionale të pafundme nga mosdija e fatit të më të dashurve të tyre.

Rrjedhimisht, përgjigja që pritej të jepej nga autoritetet, në këtë rast nga EULEX-i, duhet të ishte proporcionale me peshën e shkeljes së pretenduar dhe rëndësinë e të drejtave të mbrojtura. Në rastin e zhdukjeve, në zhvillimin e zakonshëm të ngjarjeve, kjo do të përfshinte një detyrim nga ana e autoriteteve kompetente për hetimin me zell, me shpejtësi dhe të plotë të këtyre rasteve me qëllim të gjetjes së fatit të viktimës (në parim) dhe të ndjekjes penale, gjykimit dhe dënimit të përgjegjësve.

### **Vlerësimi nga Paneli**

Paneli, duke i zbatuar parimet e përgjithshme të dhëna më lartë, shqyrtoi bazën meritore të ankesës në dy faza të ndryshme: së pari, para hyrjes në fuqi të Ligjit për juridiksionin më 13 mars 2008, dhe së dyti, pas hyrjes në fuqi të ligjit të ndryshuar më 14 prill 2014.

### **Pozita juridike para hyrjes në fuqi të Ligjit për juridiksionin**

Sa i përket periudhës së parë, Paneli ritheksoi obligimet e EULEX-i Kosovë për regjistrimin me kujdes të ankesave që paraqiten zyrtarisht dhe për komunikimin e tyre tek organet kompetente brenda EULEX-it.

Siç është marrë parasysh dhe theksuar në vendimin për pranueshmërinë, EULEX-i i kishte informatat në lidhje me rastin që nga viti 2008 e tutje. Në bazë të asaj, EULEX-i Kosovë është dashur që të sigurojë përmes organizimit të duhur dhe komunikimit mes degëve të tij të ndryshme që informatat e kësaj rëndësie të komunikoheshin tek autoritetet hetimore kompetente.



## **Pozita juridike pas hyrjes në fuqi të Ligjit për juridiksionin**

Sa i përket periudhës së dytë, pas hyrjes në fuqi të ligjit që e ndryshoi ligjin për juridiksionin, Paneli konsideronte se Ligji për juridiksionin i dha prokurorisë së EULEX-it mundësinë e zbatimit të një “përrjashtimi” ndaj parimit të përgjithshëm se rastet që nuk konsideroheshin të ishin në proces në datën e ndërprerjes, që ishte 14 prill 2014, duhej të trajtoheshin nga autoritetet e Kosovës. Kjo dispozitë do të mund të rezultonte me reduktimin apo ngritjen e përgjegjësive të EULEX-it për të vepruar çdo herë në përputhje me standardet relevante për të drejtat e njeriut.

Një nga elementet që është marrë parasysh gjatë vlerësimit të ekzistencës së “rrethanave të jashtëzakonshme” ishte ai nëse ishin ndërmarrë hetime efektive. Përgjigja negative do të ishte në favor të prokurorëve të EULEX-it për ushtrimin e kompetencës së tyre “të jashtëzakonshme”. Në pikë të parë, nuk ishte pohuar, e lëre më dëshmuar, se ky rast i ishte nënshtruar ndonjëherë ndonjë hetimi efektiv për ndonjë periudhë kohore të konsiderueshme.

Përveç kësaj, Paneli theksoi se kishte rëndësi nëse rasti kishte të bënte me të drejtat themelore dhe shkelje të peshës së rëndë. Këto elemente prapë do të ishin në favor të përfshirjes “së jashtëzakonshme” të prokurorëve të EULEX-it.

Në fund, në këtë pikë, dështimi për të siguruar se informatat relevante për këtë rast ishin bartur nga një organ i EULEX-it tek tjetri, Departamenti i Mjekësisë Ligjore, ishte konsideruar t’i atribuohet EULEX-it. Kjo e shtoi sugjerimin se rrethanat e rastit ishin “të jashtëzakonshme” në kuptimin e nenit 7(A) të Ligjit për juridiksionin.

Gjithashtu u theksua se ligji i jep prokurorisë së EULEX-it kompetencë diskreacionale të marr përsipër rastet që ata i konsiderojnë të jenë të natyrës “së jashtëzakonshme”. Paneli pranoi se nuk i përkiste Panelit t’i zëvendësojë autoritetet e EULEX-it në lidhje me aplikimin e atij kriteri. Megjithatë, ai insistoi se diskreacioni i EULEX-it Kosovë duhet të ushtrohet në një mënyrë që do të ishte në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut.

Paneli erdhi në përfundim se, prima facie, rrethanat e këtij rasti mund të konsiderohen të jenë brenda kufijve të dispozitës për “rrethanat e jashtëzakonshme” nën nenin 7(A) të Ligjit të ndryshuar për juridiksionin dhe se EULEX-i do të kishte qenë kompetent, në parim, për hetimin e rastit pas ndryshimit të ligjit të cekur. Për këto arsye, Paneli konstatoi se shkelja e të drejtave të ankuesve nga ana e EULEX-it vazhdoi edhe pas ndryshimit të ligjit të cekur për shkak se EULEX-i nuk e ka shqyrtuar rastin sipas kësaj dispozite.

### **Vendimi dhe rekomandimet**

Duke i pas parasysh rrethanat e rastit, i marrë në përgjithësi, Paneli konstatoi se përpjekjet hetimore të EULEX-it ishin të pamjaftueshme andaj kishte rezultuar në shkeljen e të drejtave të palës ankuese të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës në lidhje me respektimin e të drejtës për jetë dhe ndalimin e torturës dhe me nenin 13, e drejta për mjete juridike efektive, në lidhje me nenin 2 të Konventës.

Duke i pas parasysh konstatimet e tij në lidhje me nenet 2, 3 dhe 13 të Konventës, Paneli konsideroi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej më tej rasti në kuptim të nenit 8 të Konventës dhe i paraqiti një sërë rekomandimesh korrigjuese tek Shefi i Misionit.

### **Lënda nr. 2014-37, Y.B. kundër EULEX-it**

## **Vendimi për bazën meritore – neni 8 i Konventës**

Faktet e këtij rasti ishin se Y.B., pala ankuese, ishte përfshirë në një aktakuzë nga një prokuror i EULEX-it nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) më 4 korrik 2014. Aktakuza ishte ngritur në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër N.K. i cili akuzohej për vepra të krimit të organizuar, vrasje të rëndë dhe vepra të narkotikëve.

## **Pretendime për shkelje të neneve 6, 8, 10 dhe 11 të Konventës**

Ankuesi parashtroi se veprimet e prokurorit të EULEX-it kishin përbërë shkelje të së drejtës së tij për jetë private sipas nenit 8 të Konventës që ndërlidhej me reputacionin e personit. Në këtë rast pretendohej se EULEX-i kishte shkelur nenin 8 - E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare. Y.B. parashtroi se, përmes akuzave në publik se ai ishte pjesë e një organizate kriminale, prokurori i EULEX-i e kishte shkelur nenin 6 (1), (2) dhe (3) të Konventës. Y.B. po ashtu parashtroi se EULEX-i kishte shkelur të drejtën e tij për pjesëmarrje të lirë dhe të drejtë në zgjedhje demokratike përmes prishjes së dinjitetit dhe reputacionit të tij dhe, rrjedhimisht, karrierës së tij politike. Y.B. po ashtu u thirr në nenet 10 dhe 11 të Konventës.

## **Parashtresat nga Shefi i Misionit**

Në parashtresat e tij, Shefi i Misionit pranoi se ankuesi, së bashku me disa individë të tjerë, ishin përmendur në aktakuzë si të dyshuar për pjesëmarrje në një grup kriminal të organizuar. Megjithatë, askund nuk ishte thënë se ai kishte qenë i pandehur apo se ishte akuzuar për ndonjë vepër penale, atij i ishte dhënë vetëm statusi i dëshmitarit në atë rast.

Kur i ishte referuar në aktakuzë ankuesit, prokurori i EULEX-it e kishte konsideruar si esenciale t'iu referohej individëve të tjerë përveç N.K., me qëllim që të sigurohej që gjykata t'i dinte të gjitha faktet dhe rolet e atyre individëve në krimet për të cilat ai akuzohej. Duke e pas parasysh raportin e ankuesit me N.K, nuk do të kishte qenë e mundur që prokurori t'i paraqiste provat pa iu referuar emrit të ankuesit në aktakuzë dhe gjatë gjykimit.

## **Përgjigjet e ankuesit**

Në përgjigjet e tij, ankuesi Y.B. pohoi se aktakuza ishte e mbushur me sulme personale të peshës që do t'ia komprometonin integritetin e tij personal. Ai po ashtu kishte pohuar se as referimet ndaj tij si bashkë-kryerës i veprave, e as referimet ndaj marrëdhënies së pretenduar personale të bashkëshortes së tij, nuk i shërbenin qëllimit legjitim për kryerje të hetimeve efektive, në kuptimin e nenit 8 të Konventës.

Vetëm se provat kishin qenë relevante nuk nënkuptonte se ato duhej të deklaroheshin në aktakuzë. Edhe nëse do të ishin prezantuar në gjykatë, nuk kishte qenë e nevojshme që prokurori i EULEX-it të përmendte emrat e plotë të bashkë-kryerësve që nuk akuzoheshin. Asgjë nuk do ta kishte ndaluar atë që të përdorte pseudonime, që ishte praktikë shumë e përhapur në procedura penale të rënda. Për më tepër, motivi i pretenduar për krimin nuk ishte fakt material relevant që do të duhej të deklaroheshin në aktakuzë.

Y.B. parashtroi se asnjë prej ndërhyrjeve të prokurorit në jetën e tij private nuk i kishin shërbyer qëllimit legjitim në mënyrë proporcionale. Edhe po të pranohej legjitimiteti i qëllimit për hetime penale me ndjekje penale pasuese për vrasje, kjo nuk nënkuptonte se ndërhyrja në të drejtat e Y.B. ishte e nevojshme në këto rrethana.

Y.B. po ashtu pohoi se e drejta për ruajtjen e reputacionit të tjetrit kërkonte mbrojtje shumë më të fuqishme sesa ajo që ishte zgjedhur nga Shefi i Misionit, siç shihet nga praktika gjyqësore e GjEDNj-së. Emri i ankuesit ishte përmendur në aktakuzë menjëherë pasi ai kishte lajmëruar pjesëmarrjen e tij në zgjedhjet presidenciale, me ç'rast i kishte shkaktuar dëm edhe më të madh reputacionit të tij.

### **Vlerësimi i bazës meritore nga ana e Panelit**

Me rastin e vlerësimit të bazës meritore, Paneli ritheksoi se, në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore të GjEDNj, reputacioni i personit përbënte pjesë të së drejtës për jetë private, andaj mbrohej me nenin 8 të Konventës.

### **Kushtet për aplikimin e nenit 8 të Konventës**

Paneli vërejti se në mënyrë që të aplikohet neni 8 i Konventës, sulmi kundër nderit dhe reputacionit të personit duhet të arrijë një shkallë të caktuar të seriozitetit. Paneli theksoi se kishte pasur një numër të rasteve të mëparshme të cilat kishin të bënin me deklarata që ishin bërë gjatë zhvillimit të hetimeve apo procedurave gjyqësore ku gjykata kishte konstatuar ndërhyrje në të drejtën për jetë private të parashtruesit të ankesës.

Sa i përket pyetjes nëse ndërhyrja ishte “në pajtueshmëri me ligjin”, në pajtim me nenin 8(2), Paneli vërejti se ky aspekt nuk ishte vënë në pikëpyetje as nga palët e as nga Gjykata Themelore e Prishtinës në vendimin e saj të datës 4 dhjetor 2014. Andaj Paneli nuk pa asnjë arsye për të besuar ndryshe.

Detyra e Panelit ishte të përcaktonte nëse ndërhyrja i shërbente një qëllimi legjitim dhe nëse ajo kishte arritur “baraspeshë të drejtë” mes nevojës të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kritereve për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit. Në lidhje me nenin 8(2), Paneli pranoi se ndërhyrja ishte në kërkim të një prej qëllimeve legjitime të cekura në nenin 8(2), përkatësisht parandalimin e trazirave apo krimit. Andaj, mbeti pyetja nëse ishte arritur baraspeshë e drejtë mes interesave konkurruese publike dhe atyre private.

Në parashtrësat e tij, Shefi i Misionit pohoi se cekja e emrit të ankuesit në aktakuzë ishte esenciale për të paraqitur para Gjykatës Themelore të gjitha faktet si dhe për të filluar ndjekje penale efektive kundër N.K. Paneli nuk i kishin mjaftuar ato deklarata. Paneli e pranoi se mund të kishte qenë e pamundur të ngrihej aktakuzë kundër N.K. për krime të organizuara dhe të argumentohej rasti kundër tij pa iu referuar personave të tjerë që ishin të përfshirë.

Megjithatë, nga teksti i aktakuzës, dukej se, pa i shërbyer asnjë qëllimi në rastin kundër N.K., prokurori i EULEX-it pohoi faktin se Y.B. kishte kryer krim të rëndë. Përveç kësaj, në aktakuzë nuk ishte bërë e qartë se Y.B. nuk ishte, në fakt, i dyshuar në atë rast dhe se kundër tij nuk ishte asnjë procedurë penale në pritje. Në të kundërtën, ai me terme të qarta ishte përmendur si “bashkë-kryerës” dhe si “udhëheqës i bandës”. Këto deklarata, në vendimin e Panelit, shkuan shumë më larg sesa përshkrimi i thjeshtë i gjendjes së dyshimit.

Paneli vërejti se ai portretizim i Y.B. në një akt autoritativ prokurorial, dhe në një mënyrë që tregonte për siguri e jo për mundësi apo dyshim nga ana e prokurorit të EULEX-it, kishte mundësinë e stigmatizimit të tij dhe të pasjes së ndikimit madhor në jetën e tij dhe reputacionin personal.

## Vendimet dhe konstatimet

Duke i pas parasysh gjërat e theksuara më sipër, Paneli konstatoi se ndërhyrja në të drejtën e Y.B. për respektimin e jetës së tij private nuk ishte arsyetuar mjaftueshëm në rrethanat, dhe si e tillë, ishte në disproporcion me qëllimin legjitim të kërkuar prej prokurorit të EULEX-it. Paneli konstatoi se ndërhyrja nga prokurori i EULEX-it ka përbërë shkelje të nenit 8 të Konventës dhe ka paraqitur një sërë rekomandimesh shefit të Misionit.

### 4.4. Vendimet për pranueshmërinë

Paneli trajtoi çështje të ndryshme të rëndësishme të pranueshmërisë në vendimet si në vijim:

#### Personat e vrarë dhe personat e pagjetur

**Lëndët nr.: 2014-11 deri 2014 -17, D.W., E.V., F.U., G.T., [Zlata Veselinovic, H.S. dhe I.R., përkatësisht, kundër EULEX-it.](#)**

**Përputhshmëria me rregullën për periudhën gjashtëmujore – Ankesat duhet të paraqiten brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pretenduar, Rregulli 25 (3) i Rregullores së punës**

Këto raste të shtatë (7) ankuesve kanë të bëjnë me vrasjet e personave të përkatësisë etnike serbe, të cilat kishin ndodhur në Kosovë gjatë periudhës mes 16 qershor 1999 deri 11 mars 2000, (po ashtu shih faqen 13 më lartë).

#### Parashtresat nga Shefi i Misionit rreth pranueshmërisë – Lëndët nr. 2014-11 dhe 2014-13

Shefi i Misionit ka kundërshtuar së pari pranueshmërinë e lëndëve nr. 2014-11 dhe 2014-13, dhe ka theksuar se Paneli nuk kishte juridiksion, *ratione temporis*, në bazë të asaj se nuk kishte pasur lidhje të mjaftueshme kohore mes veprimit themelor të palëve përkatëse dhe paraqitjes së ankesave.

#### Vërejtjet nga Paneli sa i përket pranueshmërisë – lëndët nr. 2014-11 dhe 2014-13

Paneli e refuzoi deklaratën e Shefit të Misionit për arsyet si në vijim:

Së pari, Paneli theksoi se ankesat nuk ishin për vrasjet e të afërmeve të ankuesve, por për atë që konsiderohej dështim i vazhdueshëm për hetimin e plotë dhe efektiv të rasteve të tyre. Në atë kuptim, ankesat kishin të bënin me shkeljet e pretenduara të anëve procedurale kundrejt anëve materiale të neneve 2 dhe 3, përveç shkeljeve të neneve 8 dhe 13 të Konventës.

Së dyti, Paneli theksoi se ankuesit nuk pushonin së kërkuari pretendimet e tyre. Ata kërkuan ndihmesën e autoriteteve të ndryshme, vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë ndihmesën nga UNMIK-u, Qeveria britanike dhe degë të ndryshme të EULEX-it, që ata mendonin se mund t'iu ndihmonin për marrjen e informatave përkatëse.

Së treti, Paneli theksoi se, edhe pse në lidhje me këto raste nuk kishte ndonjë hetim që ishte në pritje dhe se kompetenca e prokurorëve të EULEX-it për të zhvilluar hetime mund të kishte qenë e kufizuar me amandamentimet legislative të Ligjit për juridiksionin, EULEX-i megjithatë kishte qenë i përfshirë në hetimin e këtyre çështjeve.

Në bazë të kësaj që u theksua më lartë, Paneli ishte i mendimit se ai kishte juridiksion, *ratione temporis*, për rastet meqë ekzistonte "lidhje e mirëfilltë" mes shkeljes së pretenduar të të drejtave të ankuesve dhe juridiksionit të Panelit.

#### **Parashtresat nga Shefi i Misionit në lidhje me pranueshmërinë – lëndët nr. 2014-12, 2014-14, 2014-15, 2014-16 dhe 2014-17**

Shefi i Misionit gjithashtu kundërshtoi pranueshmërinë e lëndëve nr. 2014-12, 2014-14, 2014-15, 2014-16 dhe 2014-17, *ratione materiae*, në bazë të premisë se ato nuk ishin në kuadër të kompetencës së prokurorëve të EULEX-it. Andaj, asnjë veprim apo mosveprim që kontribuoi në shkeljen e të drejtave të ankuesve nuk mund t'i ngarkohej Misionit EULEX-i Kosovë.

#### **Vendimet e Panelit në lidhje me pranueshmërinë – lëndët nr. 2014-12, 2014-14, 2014-15, 2014-16 dhe 2014-17**

Paneli nuk u pajtua me analizën e bërë nga Shefi i Misionit, dhe si çështje preliminare theksoi se ato ankesa nuk kishin të bënin me veprimin apo mosveprimin nga ana e KFOR-it apo UNMIK-ut, por me veprimet që thuhej se i atribuoheshin EULEX-it. Paneli ritheksoi se kompetenca e tij përfshinte veprimet dhe mosveprimet e pretenduara që i atribuoheshin EULEX-it në ushtrimin e mandatit të tij ekzekutiv.

Paneli së pari theksoi, në lidhje me kompetencën e tij, *ratione materiae*, se parashtresat e Shefit të Misionit pranonin se prokurorët e EULEX-it gëzonin një kompetencë të përgjithshme mbi llojet e rasteve me temën këtyre ankesave. Paneli gjithashtu vërejti pranimin që Shefi i Misionit i bëri rëndësisë së të drejtave të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës, siç pretendohet se ishin shkelur në këtë rast: ... "EULEX-i është i përkushtuar të sigurojë se të gjitha aktivitetet e tij i respektojnë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut" dhe një "natyrën themelore dhe rëndësinë e të drejtave të mbrojtura me nenet 2 dhe 3 të Konventës si dhe detyrimet procedurale në lidhje me ato të drejta".

Sa i përket kompetencës së Misionit për hetimin e këtyre rasteve të caktuara, Paneli theksoi se neni 5 i Ligjit për juridiksionin parasheh kompetencën ekskluzive të prokurorëve të EULEX-it për të hetuar dhe ndjekur penalisht, mes të tjerash, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit. Ndonëse mund të ketë debate në lidhje me atë nëse krimet e kryera në periudhën menjëherë pas konfliktit mund të cilësohen si krime të luftës apo jo, është theksuar se nuk kishte asnjë diskutim se ato krime mund të cilësohen krime kundër njerëzimit. Mbi atë bazë, Paneli përcaktoi se ato krime të luftës do të ishin vendosur brenda kompetencës së prokurorëve të EULEX-it bazuar në nenin 5 të Ligjit për juridiksionin.

Për më tepër, neni 8 i Ligjit për juridiksionin që mes tjerash ndërlidhet me rastet e rrëmbimeve dhe vrasjeve, si dhe nenet 11 dhe 12 të Ligjit për juridiksionin në lidhje me krimet e motivuara nga urrejtja do të kishin përbërë bazë ligjore alternative që prokurorët e EULEX-it t'i hetonin ato raste. Kjo në fakt ishte pranuar në përgjigjen e Shefit të Misionit, i cili theksoi se prokurorët e EULEX-it do të kishin pasur kompetencë të përbashkët për rastet që nuk mund të konsideroheshin krime të luftës por që do të binin nën kapitujt e rregullt të Kodit Penal të Kosovës.

Në vendimin e Panelit, dispozitat e cituara më sipër ishin bazë e mjaftueshme ligjore për t'i dhënë prokurorëve të EULEX-it kompetencë, qoftë ekskluzive apo të përbashkët, për hetimin e rasteve. U tha se obligimet e Misionit për hetimin e atyre rasteve nuk lindën prej atyre dispozitave që e rregullonin kompetencën juridiksionale të prokurorëve të EULEX-it për këto raste, por prej neneve 2 dhe 3 të Konventës, që mandatuan Misionin EULEX-i Kosovë të garantonte efektshmërinë e atyre të drejtave të kontekstin e mandatit ekzekutiv që kishte.

Paneli gjithashtu theksoi se Shefi i Misionit pohoi se prokurorët e EULEX-it nuk u bënë kompetent për hetimin e atyre rasteve kur dosjet e rasteve nuk kishin shkuar zyrtarisht te ta. Paneli nuk ka mundur t'i pranonte këto parashtresa për së paku dy arsye.

Arsyeja e parë ishte se ishte përgjegjësi e EULEX-it Kosovë të siguronte se ai të ishte i organizuar në atë mënyrë për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv. Paneli veçse kishte theksuar në raste të mëparshme se një misionin siç është EULEX-i pritej t'i organizonte të dhënat e veta dhe t'i bartte ato në atë mënyrë që, në të gjitha rrethanat, do të garantonte mbrojtjen efektive të të drejtave të atyre që kishin të bënin me atë lëndë, apo që prekeshin nga ato lëndë.

Arsyeja e dytë ishte se mbrojtja efektive e atyre të drejtave nuk ka mundur të varet nga aranzhimi i bërë nga UNMIK-u dhe EULEX-i në lidhje me bartjen e lëndëve të rasteve. Ankuesi në mënyrë të rregullt e ka informuar EULEX-in rreth pranisë së këtyre rasteve. Nga pikëpamja e ligjit për të drejtat e njeriut, përgjegjësia e EULEX-it për hetimin e këtyre rasteve nuk është varur dhe nuk ka mund të varet nga paraqitja zyrtare e një lënde "të drejtpërdrejtë" nga UNMIK tek EULEX-i. Ishte përgjegjësi e EULEX-it që t'i shqyrtonte dhe hetonte ato raste në mënyrë efektive kur ato ishin lajmëruar tek ta.

#### **Ligji i aplikueshëm– në "rrethana të jashtëzakonshme" – neni 7(A)**

Në shqyrtimin e tij të ligjit të aplikueshëm, si në rastin Veselinovic (më sipër), Paneli theksoi se faktorët në vijim, ndër të tjerë, do të vlenin për vlerësimin e fakteve relevante për të përcaktuar se cilat ishin "rrethana të jashtëzakonshme".

Së pari, Paneli duhet të konsiderojë nëse rasti ishte hetuar në mënyrë efektive deri në atë kohë. Përgjigja negative do të ishte në favor të prokurorëve të EULEX-it për ushtrimin e kompetencës së tyre "të jashtëzakonshme". Paneli konstatoi se këto raste nuk ishin hetuar në mënyrë të plotë dhe efektive nga asnjë entitet dhe për asnjë periudhë të konsiderueshme kohore.

Së dyti, Paneli tha se ai duhet të konsiderojë nëse çështjet për të cilat ishin paraqitur ankesa kanë të bëjnë me të drejtat themelore të rëndësishme dhe se shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut kishin peshë të jashtëzakonshme. Këto konsideromë do të ishin në favor të përfshirjes së "jashtëzakonshme" të prokurorëve të EULEX-it. Në këtë drejtim, të gjitha rastet nën shqyrtim kanë të bëjnë me të drejtat themelore të rëndësishme, përfshirë të drejtën për jetë.

Së treti, nëse prokurorët e EULEX-it kishin vendosur që mos t'i ushtronin kompetencat e tyre të "jashtëzakonshme", atëherë ngritet pyetja nëse kishte pasur mundësi të mirëfilltë dhe të vërtetë që autoritetet vendore t'i përmbushnin përgjegjësitë e tyre hetimore. Paneli theksoi se nuk kishte asnjë indikacion se situata do të ishte e tillë apo që ishin ndërmarrë veprime të duhura për gjetjen e fakteve në këtë drejtim.

Paneli theksoi se nga ankuesit pritej, në parim, që me këmbëngulje të kërkonin mjetet juridike që ishin në dispozicion të tyre dhe t'i paraqisnin ankesat me shpejtësinë e duhur. Në këtë rast të caktuar, ankuesit duket se nuk kanë ndërmarrë asnjë hap domethënës në drejtim të kërimit të mjeteve juridike të ndryshme që ishin në dispozicion të tyre deri në vitin 2013. Paneli theksoi se ankuesit nuk kishin dhënë asnjë shpjegim për këtë vonesë.

## **Vlerësimi i pranueshmërisë nga Paneli**

Paneli, në përcaktimet e tij sa i përket pranueshmërisë theksoi, megjithatë, se ekzistonin katër arsye që ishin në favor të shqyrtimit të mëtejshëm të këtyre rasteve.

Së pari, të drejtat që përfshiheshin të këto raste ishin mes të drejtave themelore më të rëndësishme të garantuara me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe në të vërtetë disa prej tyre janë absolute dhe nuk lejojnë përjashtime.

Së dyti, kompetenca e prokurorëve të EULEX-it për hetimin e shkeljeve të pretenduara të këtyre të drejtave ishte e pavarur prej çfarëdo ankese të paraqitur nga viktimat apo familjarët e tyre, andaj kishte pritje të bazuar në ligj se ata do ta hetonin këtë rast pavarësisht veprimeve të ankuesit.

Së treti, hetimet e plota dhe efektive të krimeve të kësaj kategorie ishin thelbësore për krijimin e një ndjenje të llogaridhënies dhe kujdesit për sundimin e ligjit në shoqëri pas konflikteve. Përgjegjësia për trajtimin e këtyre rasteve i takonte shoqërisë në përgjithësi e jo vetëm atyre që ishin prekur më së drejtpërdrejt nga rastet.

Së treti, Paneli rikujton se, në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore të GjEDNj, periudha gjashtëmujore, brenda të cilës duhej të paraqitej ankesa, mund të llogaritet nga koha kur ankuesi njoftohet se rasti i tij nuk ishte duke u hetuar siç duhet nga ana e autoriteteve përgjegjëse. Në bazë të kësaj, Paneli konsideroi se ishte në interesat më të mirë të drejtësisë që të shqyrtonte ankesën në lidhje me pranueshmërinë e saj.

Përveç këtyre, ankesat nr. 2014-11 dhe 2014-13 ishin paraqitur para Panelit më 11 mars 2014. Ankuesit pranuan korrespondencat e fundit nga Prokurori Special i Republikës së Kosovës, përkatësisht më 20 shtator dhe 9 tetor 2013. Paneli ishte i mendimit se këto data me të drejtë mund të shikohen si pikat në periudhën kohore prej të cilave rregulli për afatin gjashtëmujor filloi të llogaritej meqë ishte nga ajo datë që ankuesit padyshim do të kuptonin se EULEX-i nuk do të zhvillonte hetime efektive në lidhje me vdekjet e familjarëve të tyre.

## **Vendimet dhe konstatimet**

Për këto arsye, Paneli deklaroi se ankesa ishte paraqitur me kohë dhe kishte konstatuar se kushtet relevante të juridiksionit ishin përmbushur, andaj rasti do të mund të shpallej i pranueshëm.

**Lënda nr. 2014-34, [Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#).**

## **Personat e vrarë dhe personat e pagjetur**

**Pajtueshmëria me rregullin për periudhën gjashtëmujore – Ankesat duhet të paraqiten brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pretenduar, rregulli 25 (3) i Rregullores së punës**

Viktima në këtë rast, z. Sylë Sadiku, babai i ankuseses, ishte zhdukur më 7 dhjetor 2000 nga banesa e tij në pjesën veriore të Mitrovicës gjatë një sulmi nga persona të armatosur, që besohet se kishin qenë të përkatësisë etnike serbe (shih faqe 14 më lartë).

## **Parashtresat nga Shefi i Misionit**

Në lidhje me pranueshmërinë e ankesës, Shefi i Misionit parashtroi se prokurorët e EULEX-it ishin njoftuar rreth rastit vetëm atëherë kur ankuesja kishte bërë kërkesë në vitin 2013. Ai gjithashtu

parashtrori se EULEX-i nuk kishte ndërmarrë asnjë hap hetimor për këtë rast, meqë brenda policisë apo prokurorisë së EULEX-it nuk kishte pasur asnjë hetim të hapur dhe se nuk kishte asnjë dosje të hapur hetimore që ishte bartur nga UNMIK-u tek EULEX-i.

Shefi i Misionit po ashtu komentoi rreth kompetencës së prokurorisë së EULEX-it për trajtimin e rastit. Ai parashtrori se, para amendamenteve legjislative bërë Ligjit për juridiksionin, prokurorët e EULEX-it do të kishin pasur vetëm kompetenca të përbashkëta apo dytësore për këtë rast, nëse ai ishte klasifikuar si kidnapim, mbajtje peng apo vrasje.

Shefi i Misionit pohoi se ngjarja kishte ndodhur pas përfundimit të konfliktit, rasti nuk mund të konsiderohej si krim i luftës, në të cilin rast EULEX-i do të kishte pasur kompetenca ekskluzive. Shefi i Misionit shtoi se amendamentimet e Ligjit për juridiksionin ulën mundësinë e prokurorëve të EULEX-it për ushtrimin e funksioneve ekzekutive për raste të reja.

### **Vërejtjet e Shefit të Misionit në lidhje me pranueshmërinë**

Shefi i Misionit parashtrori se detyra kryesore e EULEX-it ishte t'i mbështeste autoritetet e Kosovës dhe njëkohësisht t'i kishte disa funksione ekzekutive të kufizuara. Andaj, përgjegjësia e EULEX-it për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nuk mund të barazohej me përgjegjësinë e një shteti.

Shefi i Misionit po ashtu parashtrori se Paneli ishte kompetent vetëm për shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it. Andaj ankesat që kishin të bënin me veprimet apo mosveprimet si të KFOR-it, UNMIK-ut apo autoriteteve të Kosovës, ishin jashtë kompetencës së tij.

Më tej, Shefi i Misionit parashtrori se Paneli duhet t'i shqyrtojë vetëm ankesat për shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut që kishin ndodhur pas datës 9 dhjetor 2009 dhe ai theksoi se babai i ankueses ishte zhdukur në vitin 2000. Shefi i Misionit po ashtu parashtrori se rasti ishte paraqitur jashtë kufirit të periudhës gjashtëmujore të përcaktuar në Rregulloren e punës së Panelit.

### **Parashtresat nga ankuesja**

Ankuesja, në përgjigjet e saj ndaj parashtresave nga Shefi i Misionit, hodhi poshtë pohimin se zhdukja e babait të saj nuk mund të konsiderohej krim lufte. Ajo citoi nenin 1 të Ligjit 04/L-023 për personat e zhdukur në Kosovë, në të cilin theksohet se personi "i raportuar si i zhdukur gjatë periudhës [mes] 1 janar 1998 [dhe] 31 dhjetor 2000" konsiderohet person i pagjetur "si pasojë e luftës në Kosovë gjatë 1998-1999".

Meqë babai i ankueses ishte zhdukur para datës 31 dhjetor 2000, ajo parashtrori se kishte prezumim statutor se zhdukja e tij ishte shumë e lidhur me konfliktin në Kosovë, çka përbënte krim të luftës.

Ankuesja konkludoi se, nëse EULEX-i nuk i shfrytëzon të gjitha mjetet e mundshme që i ka në dispozicion me qëllim të përmbushjes së obligimit të tij për zhvillim të hetimeve, të drejtat e ankueses të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës, si dhe procedura para panelit për mbrojtjen e atyre të drejtave, do të ishin teorike dhe iluzore.

Andaj ankuesja ka kërkuar nga Paneli që ta udhëzojë EULEX-in të shfrytëzojë nenin 7 (A) të Ligjit për juridiksionin, i cili i referohej mundësisë që rasti t'i caktohet EULEX-it, dhe mjeteve të tjera në dispozicion për hetim efektiv të rastit. Ankuesja po ashtu ka kërkuar kompensim për dëmin që i ishte shkaktuar.



## **Vlerësimi i Panelit (përgjegjësitë e shteteve kundrejt organizatave ndërkombëtare)**

Në përcaktimin e tij sa i përket pranueshmërisë së këtij rasti, Paneli, si në rastin Veselinovic (më sipër), theksoi se EULEX-i Kosovë nuk ishte shtet dhe se mundësia e tij për garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohej në të gjitha aspektet relevante me atë që mund të pritet prej një shteti. Paneli gjithashtu i pranoi vështirësitë që me doemos përfshiheshin gjatë hetimit të krimeve të rënda në një shoqëri pas konflikti, siç ishte shoqëria në Kosovë. Ato vështirësi, megjithatë, nuk duhet të shërbejnë për t'i kamufluar apo shpjeguar dështimet që në asnjë mënyrë domethënëse nuk ishin të ndërlidhura me mangësitë e hetimit.

Paneli pranoi se pritshmëritë e vendosura mbi mundësinë e EULEX-it për të hetuar dhe zgjidhur rastet penale të ndërlikuara duhet të jenë realiste. Andaj Paneli në secilin rast do të vlerësonte nëse ka patur pengesa konkrete dhe të vërteta që do ta dobësonin mundësinë e EULEX-it për kryerjen e hetimeve të shpejta dhe efektive.

Paneli theksoi se në çdo rast dhe në veçanti në një rast kaq të rëndë si ky, nga autoritetet hetimore është pritur që të veprojnë me arsye dhe shpejtësi dhe të investonin burime që do të korrespondojnë me nevojën dhe mundësinë e zgjidhjes së rastit. Në kontekstin aktual, mund të kishte pak mospajtime se hetimi i fatit të të pagjeturve, pavarësisht përkatësisë fetare apo etnike, duhet të ishte prioritet operacional për EULEX-in si misionin për sundim të ligjit.

## **Parashtrësit nga Shefi i Misionit**

Shefi i Misionit më tej parashtrëtoi se ankuesja nuk e kishte respektuar rregullin për periudhën gjashtëmujore, çka do të dukej se ishte bazuar në një keqkuptim të qëllimit të ankesës. Ndonëse babai i ankueses ishte zhdukur më 7 dhjetor 2000, shkelja e pretenduar e të drejtave që janë relevante për ankesën në fjalë nuk i përket asaj ngjarje por dështimit të pretenduar pasues dhe në vazhdim e sipër nga ana e EULEX-it për hetimin e duhur të rrethanave të asaj zhdukje.

## **Vendimi i Panelit**

Paneli konstatoi se faktorë të caktuar, si në rastin e mëparshëm, kërkonin që paneli ta shqyrtonte këtë çështje më tej.

Së pari, të drejtat e përfshira ishin në mesin e të drejtave themelore të rëndësishme të garantuara me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, disa prej të cilave janë absolute dhe nuk lejojnë përjashtime.

Së dyti, Paneli theksoi se kompetenca e prokurorëve të EULEX-it për hetimin e shkeljeve të pretenduara të këtyre të drejtave ishte e pavarur prej çfarëdo ankese të paraqitur nga viktimat apo familjarët e tyre, andaj kishte pritshmëri ligjërish të bazuar se ata do ta hetonin këtë rast, pavarësisht veprimeve të ankueses.

Së treti, Paneli përcaktoi se hetimi i plotë dhe efektiv i kësaj kategorie të rasteve ishte thelbësor për krijimin e një ndjenje të llogaridhënies për sundimin e ligjit në çdo mjedis pas konfliktit. Përgjegjësia për trajtimin e këtyre rasteve i përkiste shoqërisë si tërësi e jo vetëm atyre që ishin prekur më së drejtpërdrejt nga to. Në bazë të kësaj, Paneli konsideroi se ishte në interesa të drejtësisë që ai ta konsideronte ankesën në lidhje me pranueshmërinë e saj.

### **Parashtrësit e Shefit të Misionit - racione temporis**

Shefi i Misionit më tej parashtrëtoi se Paneli nuk kishte juridiksion, *ratione temporis*, në mungesë të një lidhjeje të mjaftueshme kohore mes veprimit themelor dhe paraqitjes së ankesës. Shefi i Misionit theksoi faktin se babai i ankueses ishte zhdukur para një kohe shumë të gjatë si dhe para themelimit të EULEX-it në vitin 2008.

### **Vendimi i Panelit - racione temporis**

Paneli përcaktoi se fakti që babai i ankueses kishte ishte zhdukur në dhjetor të vitit 2000 jo me doemos nënkupton se Paneli nuk do të ishte kompetent për hetimin e këtij rasti. Veprimi që ishte nën shqyrtim në këtë rast, një dështim i pretenduar nga ana e EULEX-it Kosovë për ta hetuar këtë rast, është veprim që ka filluar së paku në dhjetor 2013, në mos më parë, dhe për të cilin thuhej se ka qenë në vazhdim e sipër deri në këtë kohë. Në këtë kuptim, Paneli konstatoi se ai ishte nën juridiksionin kohor të Panelit.

### **Vendimi dhe konstatimet**

Në bazë të kësaj që u cek më lartë, Paneli ishte i bindur se kishte lidhje të mjaftueshme dhe të mirëfilltë mes veprimit themelor relevant për këtë rast dhe mandatit të EULEX-it si dhe kompetencës së Panelit. Paneli e deklaroi veten kompetent, për nga racione temporis, për shqyrtimin bazës meritore të rastit.

### **Parashtrësit e Shefit të Misionit - racione materiae**

Shefi i Misionit po ashtu kundërshtoi pranueshmërinë e këtij rasti, për nga *ratione materiae*, në bazë të asaj se ky rast nuk binte nën kompetencën e prokurorëve të EULEX-it, andaj asnjë veprim apo mosveprim që ka mund t'i kontribuonte shkeljes së të drejtave të ankueses nuk mund t'i atribuohet EULEX-it.

### **Vendimi i Panelit - racione materiae**

Paneli theksoi se parashtrësit e bëra nga Shefi i Misionit tashmë kishin paraparë qartë faktin se prokurorët e EULEX-it gëzonin kompetencë të përgjithshme për këtë lloj të rasteve.

Shefi i Misionit, në komunikimet e mëparshme, kishte marrë parasysh rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës, të pretenduara si të shkelura në këtë rast; "EULEX-i është i përkushtuar për të siguruar se të gjitha aktivitetet e tij i respektojnë standardet e të drejtave të njeriut", dhe e njeh "karakterin dhe rëndësinë themelore të të drejtave të mbrojtura me nenet 2 dhe 3 të Konventës si dhe obligimet procedurale në lidhje me ato të drejta".

Paneli gjithashtu theksoi faktin se Shefi i Misionit e kishte bërë të qartë se, nëse informata të reja ishin vënë në dispozicion të EULEX-it, ai do të kishte mundur 'ta aktivizonte' këtë rast, duke pranuar kështu kompetencën e përgjithshme të EULEX-it për këtë rast.

Paneli erdhi në përfundimin se, duke e lënë anash pyetjen nëse ky akt do të mund të ishte cilësuar si krim i luftës, veprimi në fjalë, *prima facie*, kishte bartur indikacione se ai kishte qenë i motivuar etnikisht andaj do të ishte përfshirë nën "krimet e tjera të rënda" të parapara me nenin 3(d) të Veprimit të Përbashkët të vitit 2008, për të cilët prokurorët e EULEX-it kishin kompetenca.

Paneli po ashtu theksoi se neni 8 i Ligjit për juridiksionin që kishte të bënte me kidnapimet, pengmarrjet dhe vrasjet, dhe nenet 11 dhe 12 të Ligjit për juridiksionin që ka të bëjnë me krimet e motivuara nga urrejtja do të kishin përbërë bazë juridike të vlefshme që prokurorët e EULEX-it ta hetonin këtë rast.

### **Parashtrësit e mëtejme nga Shefi i Misionit - *ratione materiae***

Shefi i Misionit deklaroi, megjithatë, *ratione materiae*, se këto dispozita nuk: “krijonin obligim të genësishëm që prokurorët e EULEX-it të vepronin”. Megjithatë, pyetja këtu nuk ka të bëjë me “obligimin”, por me juridiksionin apo kompetencën e prokurorëve të EULEX-it për zhvillim të hetimeve. Dhe dispozitat juridike të cituara më sipër parashohin qartë bazën juridike që i autorizonte prokurorët e EULEX-it për hetimin e këtij rasti.

Shefi i Misionit po ashtu ngriti një “përgjashtim” tjetër ndaj kompetencës së prokurorëve të EULEX-it, përkatësisht, zbatimin e afatit të parashkrimit për veprat që do të cilësoheshin si kidnapime apo pengmarrje. Afati i parashkrimit për këto vepra duket se sillet mes 10 deri 20 vite, varësisht nga rrethanat e rastit, (nenet 106, 175 dhe 194 të Kodit Penal të Kosovës).

Shefi i Misionit po ashtu parashtrëtoi se “legjislacioni i ri” që ka hyrë në fuqi më 17 maj 2014 “ka reduktuar në mënyrë domethënëse mundësinë e prokurorëve dhe gjyqtarëve të EULEX-it për ushtrimin e funksioneve ekzekutive në raste të reja”, (Ligji omnibus për amandamentimin e Ligjit për juridiksionin).

### **Vendimet e Panelit - *ratione materiae***

Paneli së pari theksoi se Shefi i Misionit nuk kishte ngritur këtë përgjashtim në lidhje me veprimet që do të mund të cilësoheshin si vrasje dhe/apo krime të motivuara etnikisht, andaj ky aspekt i rastit nuk do të prekej.

Së dyti, Paneli përcaktoi se edhe nëse veprimi themelor ishte konsideruar plotësisht apo pjesërisht të cilësohej si kidnapim apo pengmarrje, përgjegjësia e EULEX-it për të hetuar do të ishte shuar diku në vitin 2010. Dështimi i tij për hetimin e rastit deri në atë periudhë kohore prapë se prapë do të ngriste çështje sipas neneve 3 dhe 8, dhe ndoshta edhe sipas nenit 13 të Konventës.

Sa i përket komenteve të Shefit të Misionit për ligjin Omnibus si më lartë, Paneli theksoi se, megjithatë, neni 7(A) kishte paraparë “Autoritetin e prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme...Në rrethana të jashtëzakonshme rasti do t’i caktohej ndonjë prokurori të EULEX-it me vendim të përbashkët nga kryeprokurori i shtetit dhe autoriteti kompetent i EULEX-i Kosovë.”

### **Vendimi dhe konstatimet e Panelit**

Në bazë të arsyeve si më sipër, Paneli ishte i bindur se të gjitha kushtet relevante sa i përket juridiksionit në lidhje me pranueshmërinë e rastit ishin përmbushur dhe e shpalli rastin si të pranueshëm.

### **Lënda nr. [2014-36 Z.A. kundër EULEX-it](#)**

**Juridiksioni i Panelit, rregulli 25 (1) dhe neni 29 (d) i Rregullores së punës – Kompetenca e Panelit për shqyrtimin e procedurave gjyqësore të gjykatave të Kosovës**

## **Faktet**

Faktet e këtij rasti ishin se më 17 shtator 2010 ankuesi kishte paraqitur kërkesë për njohjen e statusit të tij si veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në degën e organizatës në Pejë. Ankuesi ishte thirrur në disa dispozita të Kushtetutës së Kosovës, në Deklaratën për të drejtat e njeriut, në Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike. Në thelb, ai kishte kërkuar statusin e veteranit të UÇK-së.

## **Vlerësimi nga Paneli**

Paneli kuptoi se ankesat e ankuesit ishin rreth një mosmarrëveshje mes tij dhe organizatës së veteranëve të UÇK-së në lidhje me statusin e tij si veteran. Ankuesi ishte përpjekur pa sukses që rastin e tij ta paraqiste në gjykatat e Kosovës. Sipas rregullit 25 par. 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies në planin operacional të EULEX-it Kosovë, Paneli në parim nuk mundet t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka juridiksion mbi aspektet administrative apo gjyqësore të punës së këtyre gjykatave. Rrjedhimisht, Paneli përcaktoi se ai nuk mundte të ndikonte mbi rezultatin e procedurave gjyqësore apo mbi shpejtësinë e shqyrtimit të ankesave nga gjykatat e Kosovës. Edhe kur gjyqtarë të EULEX-it marrin pjesë në procedura, kjo nuk e mënjanon faktin se ajo gjykatë është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës.

## **Vendimi dhe konstatimi**

Ankesa ishte jashtë juridiksionit të Panelit siç është e formuluar në rregullin 25 të Rregullores së punës dhe në planin operacional të EULEX-it Kosovë. Andaj, Paneli, njëzëri, konstatoi se ai nuk kishte kompetencë për shqyrtimin e ankesës, meqë ajo ishte jashtë juridiksionit të tij në kuptim të nenit 29 (d) të Rregullores së punës, dhe e shpalli ankesën të papranueshme.

## **Lënda nr. 2015-10 [Shaban Sylja kundër EULEX-it](#)**

### **Juridiksioni i Panelit, rregulli 25 (1) dhe neni 29 (d) i Rregullores së punës – Kompetenca e Panelit për shqyrtimin e procedurave gjyqësore të gjykatave të Kosovës**

## **Faktet**

Më 17 dhjetor 2012, ankuesi ishte dënuar për vrasje të rëndë në tentativë nga Gjykata Themelore e Prishtinës. Ai ishte dënuar me tetë vite burgim.

## **Parashtresat nga ankuesi**

Ankuesi kishte parashtruar se ai kishte qenë në arrest shtëpiak nga 6 maj 2011 deri më 23 mars 2015, dhe se të drejtat e tij themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ishin shkelur. Ankesa dukej se kishte të bënte me çështjen e zbritjes së periudhës që ai kishte kaluar në arrest shtëpiak nga dënimi. Ndonëse natyra e saktë e ankesës së tij ishte disi e paqartë, Paneli kuptoi se ankesa ishte kundër vendimit/vendimeve të gjykatave të Kosovës në lidhje me burgosjen e tij.

## **Vlerësimi i Panelit**

Paneli, në disa raste ka konstatuar se, sipas rregullit 25, par. 1, të Rregullores së Punës, bazuar në konceptin e llogaridhënies në planin operacional të EULEX-it Kosovë, në parim, Paneli nuk mundet t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës.

Sipas rregullit 25 të rregullores së punës dhe planit operacional të EULEX-it Kosovë, ankesa ishte jashtë mandatit të Panelit. Paneli nuk ishte bindur se ankuesi kishte demonstruar se veprimi për të cilin ai ishte ankuar mund t'i atribuohet EULEX-it.

Më tej, Paneli theksoi se veprimi për të cilin ishte bërë ankesa duket se është jashtë afatit kohor gjashtëmujor brenda të cilit duhet të paraqitet ankesë tek Paneli, sipas rregullit 25(3), Rregullorja e punës.

### **Vendimi dhe konstatimet**

Paneli njëzëri deklaroi se ankesa ishte e papranueshme meqë Paneli nuk kishte kompetencë për shqyrtimin e ankesës, meqë ajo ishte jashtë juridiksionit në kuptim të nenit 29 (d) të Rregullores së punës dhe nuk ishte sipas nenit 25(3) të Rregullave në aspektin e afatit kohor për paraqitjen e ankesës.

### **Lënda nr. 2015-01, [Milos Jokic kundër EULEX-it](#)**

#### **Jurisdiksioni i Panelit, rregulli 29 (d) i Rregullores së Punës – Kompetenca e Panelit për shqyrtimin e procedurave gjyqësore në gjykatat e Kosovës**

#### **Faktet**

Faktet e ankesës ishin se ankuesi ishte arrestuar më 26 gusht 1999 nën dyshime të kryerjes së veprave të gjenocidit. Ai ishte dënuar për krime të luftës dhe më 20 qershor 2000 ishte dënuar me njëzet (20) vite heqje lirie. Pas një rigjykimi, ai ishte liruar nga të gjitha akuzat dhe më 3 maj 2002 ishte liruar nga burgimi. Në prill të vitit 2009, ankuesi kishte paraqitur kërkesë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër Qeverisë së Kosovës për kompensim për burgim të paarsyeshëm. Ankuesi pretendoi se e drejta e tij për gjykim të drejtë brenda një periudhe të arsyeshme siç garantohet me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (Konventa) dhe me nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (Deklarata) ishte shkelur. Ai po ashtu pohoi se nuk kishte pasur asnjë mjet juridik efektiv për parandalimin e shkeljeve të mëtejme të të drejtave të tij, shkelje kjo e nenit 13 të Konventës dhe nenit 8 të Deklaratës. Ai më tej pretendoi shkeljen e nenit 5(5) të Konventës (e drejta për kompensim për burgim të paligjshëm).

#### **Parashtresa nga ankuesi**

Paneli erdhi në përfundim se parashtresë i ankesës ankohej ekskluzivisht rreth veprimeve apo dështimeve të pretenduara të gjyqësorit të Kosovës në gjykatat e Kosovës.

### **Vendimi dhe konstatimet**

Paneli njëzëri vendosi se Paneli nuk e kishte kompetencën për shqyrtimin e ankesës, meqë ajo ishte jashtë juridiksionit të tij në kuptimin e nenit 29 (d) të Rregullores së punës, dhe se ajo po ashtu nuk ishte në përputhje me nenin 25(3) të rregullave për afatin kohor.

### **Lënda nr. 2015-09 [Driton Hajdari kundër EULEX-it](#)**

## **Juridiksioni i Panelit, rregulli 29 (d) i rregullores së punës – Kompetenca e Panelit për shqyrtimin e procedurave gjyqësore të gjykatave të Kosovës**

### **Faktet**

Faktet e këtij rasti ishin se më 17 dhjetor 2012, Gjykata e qarkut e Prishtinës e dënoi ankuesin dhe katër bashkëkryerës të tjerë për veprën e vrasjes së rëndë në tentativë. Ankuesi ishte dënuar me shtatë vite burgim.

### **Parashtresat nga ankuesi**

Ankuesi parashtroi se ai ishte dënuar gabimisht dhe ai protestoi për pafajësinë e tij. Ai po ashtu u ankua se paraburgimi i tij kishte qenë i paligjshëm. Paneli theksoi se ankesat e ankuesit kishin të bënin me procedurat gjyqësore dhe dënimin e tij gjoja se të padrejtë nga gjykatat e Kosovës.

### **Vendimi i Panelit**

Paneli e shqyrtoi ankesën në bazë të juridiksionit të Panelit, rregulli 29 (d) i Rregullores së punës: kompetenca e Panelit për shqyrtimin e procedurave gjyqësore të gjykatave të Kosovës.

Paneli njëzëri konstatoi se paneli nuk e kishte kompetencën për shqyrtimin e ankesës meqë ajo ishte jashtë juridiksionit në kuptim të nenit 29 (d) të Rregullores së punës, dhe për arsye se ankesa nuk kishte qenë e plotësuar me prova, e shpalli atë të papranueshme.

### **Lënda nr. 2015-03 [Dekart Shkololli kundër EULEX-it](#)**

## **Neni 29 (e), Rregullorja e punës – Ankesa e pabazuar**

### **Faktet**

Faktet siç janë paraqitur ishin se ankuesi ishte shpallur fajtor dhe dënuar me burgim në Gjermani, edhe pse nuk kishte ofruar asnjë hollësi rreth natyrës së dënimit të tij. Ankuesi e kishte një djalë, të lindur në vitin 1997, i cili siç duket jeton në Gjermani. Ai është ndarë nga djali i tij që nga viti 2004.

### **Parashtresa nga ankuesi**

Ankuesi ka pohuar se ai ishte dënuar dhe burgosur në mënyrë të padrejtë. Po ashtu, duket që ai ankohet se është ndarë nga djali i vet dhe kërkon të bashkohet me të. Ai ka kërkuar kompensim për padrejtësinë për të cilën ai thotë se i është bërë atij..

### **Vendimi i Panelit**

Paneli e ka shqyrtuar këtë lëndë në kontekstin e Rregullës 29 (e), Rregullorja e punës – Ankesa e pabazuar.

Paneli kishte vërejtur se ankesa e ankuesit dukej se kishte të bënte me procedurat penale pranë gjykatave në Gjermani dhe arrestimit të tij atje. Po ashtu, dukej se ajo kishte të bënte me përkujdesjen ndaj djalit të tij. Nuk është argumentuar, e as që është treguar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në këto çështje në çfarëdo cilësie.

Ai ka vazhduar duke thënë që kjo ankesë binte jashtë kuadrit të mandatit ekzekutiv të EULEX-i Kosovë dhe, rrjedhimisht, jashtë kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe në OPLAN-in e EULEX-it Kosovë.

Paneli njëzëri ka konstatuar se ankesa ishte qartazi e pabazuar sa i përket kuptimit të Neni 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe e ka shpallur ankesën të papranueshme.

#### **Lënda nr. 2015-13 [W.D. kundër EULEX-it](#)**

#### **Neni 29 (e), Rregullorja e punës – Ankesa e pabazuar**

##### **Faktet**

Faktet e lëndës, siç janë paraqitur nga ankuesi, ishin se në fund të gushtit të vitit 2012, ai kishte bërë një raport në EULEX kundër S.H., i cili ishte përshkruar si *“Shef i grupit të Kuvendit të LDK-së”*. Është supozuar se S.H. i kishte kërkuar rryshfet ankuesit që konsistonte nga një makinë apo 30.000 euro për t’ia ndryshuar shfrytëzimin e tokës së ankuesit nga tokë bujqësore në tokë për ndërtim. Ankuesi nuk kishte pranuar që të paguante dhe si rezultat i kësaj, ai thotë se ishte sulmuar.

Ankuesi e kishte raportuar çështjen në policinë e EULEX-it dhe kishte pretenduar se atij i ishte ofruar mbrojtje nga EULEX-i. Ai tha se hetuesit i kishin vendosur përgjues ndërsa ai kishte vazhduar të bënte marrëveshje me të dyshuarin duke u shtirur se ishte pjesë e planit të supozuar të S.H. dhe bashkëpunëtorëve të tij: A.A. dhe M.R. Ankuesi tha se e mori një makinë dhe u takua me S.H., A.A. dhe M.R. më 5 shtator 2012. Incizimi i bisedës ishte dërguar më pas në Zyrën për Përkthim të EULEX-it rreth orës 14:30 në të njëjtën datë. Në orën 15:30, brenda një ore pasi kasetat inkriminuese ishin dërguar në Zyrën për Përkthim të EULEX-it, S.H. thuhet ta ketë telefonuar A.A., i shqetësuar duke thënë se nuk dëshironte ta blinte makinën. Ankuesi nga kjo konkludon se incizimi kishte rrjedhur nga Zyra për Përkthim e EULEX-it. Ishte pohuar se S.H., A.A. dhe M.R. po hetoheshin për korrupsion, por akuza ishte ngritur vetëm ndaj A.A. dhe M.R.

##### **Parashtresa nga ankuesi**

Ankuesi ka pohuar shkelje të dispozitave të mëposhtme të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut (Konventa): nenet 3, 6 dhe 8 të Konventës. Në veçanti, ankuesi ka pohuar se përmbajtja e bisedës së përgjuar ishte rrjedhur nga Zyra për Përkthim e EULEX-it duke e vënë në rrezik sigurinë e tij. Ankuesi gjithashtu pretendon se përkthimi që i është bërë bisedës së incizuar nuk e pasqyronte me saktësi shqetësimin e S.H. Si rezultat i kësaj, ai thotë se prokurori holandez e kishte hedhur poshtë lëndën ndaj S.H. në bazë të një përkthimi jo të duhur. Lënda ishte bartur më pas te një prokuror italian, i cili refuzoi shqyrtimin e mëtejshëm të lëndës së S.H.-së mbi bazën se tashmë ishte ngritur një aktakuzë. Ankuesi gjithashtu pretendon se prokurori italian ishte i vrazhdë, i pasjellshëm dhe nuk donte të dëgjonte asnjë kërkesë nga ai për hetimin e rrjedhjes së incizimit.

##### **Vendimi i Panelit**

Pasi i ka shqyrtuar veprimet/mosveprimet për të cilat është bërë ankesa, Paneli ishte i mendimit se ankesa në parim bënte pjesë në kuadër të juridiksionit të tij. Paneli kishte theksuar se ankuesi së pari pohonte se përmbajtja e bisedës së përgjuar ishte rrjedhur nga Zyra për Përkthim e EULEX-it. Pasi i ka shqyrtuar dëshmitë e dhëna nga ankuesi, Paneli ka konkluduar se nuk kishte prova të besueshme për të dëshmuar se biseda e incizuar ishte rrjedhur dhe se kjo rrjedhje kishte bërë nga EULEX-it. Pas shqyrtimit të materialit dhe informacionit të dhënë nga ankuesi, Paneli nuk është

bindur se ai e ka vërtetuar sugjerimin se çfarëdo veprimi dhe/ose mosveprimi që i atribuohet EULEX-it nga ana e tij kishte përbërë apo përfshirë shkelje të drejtave të tij themelore. Prandaj, Paneli i kishte konsideruar këto pretendime qartazi të pabazuara.

Lidhur me aspektet e tjera të ankesës, Paneli nuk është bindur se akuzat janë vërtetuar në mënyrë adekuate nga ankuesi apo që ato përbëjnë shkelje të drejtave të tij themelore aty ku janë vërtetuar. Prandaj, këto aspekte të ankesës janë qartazi të pabazuara.

Prandaj, Paneli njëzëri ka konstatuar se ankesa ishte qartazi e pabazuar sa i përket kuptimit të Neni 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe e ka shpallur ankesën të papranueshme.

#### **Lënda nr. 2015-08 [Afrim Berisha kundër EULEX-it](#)**

### **Rregulla 25 (2) Neni 29 (d) i Rregullores së vet të punës – juridiksioni kohor i Panelit**

#### **Faktet**

Faktet e ankesës siç janë paraqitur nga ankuesi ishin se më 18 qershor 2000, në orën 10.00, ankuesi ishte duke vozitur makinën e tij për në punë, në Hotel Grand në Prishtinë. Ai qe ndaluar afër hotelit nga Policia e Kosovës, por pasi e kishte identifikuar veten ai ishte lejuar që të voziste drejt vendit të tij të punës dhe ta parkonte veturën e tij në parkingun e hotelit. Ankuesi kishte deklaruar se arsyeja përse rruga ishte e bllokuar ishte se dyshohej për një bombë në hyrjen kryesore të Hotelit Grand. Ankuesi deklaroi se KFOR-i i kishte kontrolluar, duke e përfshirë veturën e tij dhe se KFOR-i e kishte përdorë një robot për ta kontrolluar veturën e tij. Ankuesi deklaroi se KFOR-i vendosi dinamit në pjesën e pasme të veturës së tij dhe e kreu një shpërthim të kontrolluar i cili i kishte shkaktuar dëmtime në pjesën e pasme të veturës së tij.

Ankuesi kishte shkuar tek përfaqësues të ndryshëm të KFOR-it dhe UNMIK-ut, ndërsa tek përfaqësuesi i KFOR-it ai e kishte dorëzuar një CD me një incizim të tërë ngjarjes lidhur me dëmtimin e automjetit të tij. Ankuesi deklaroi se KFOR-i e kishte informuar atë se ata do të paguanin për dëmin dhe se do ta kontaktonin me telefon, por kjo gjë nuk kishte ndodhur. Ankuesi thekson se ai ishte përpjekur po ashtu në tre raste, një herë në vitin 2014 dhe dy herë në vitin 2015, që të kontaktonte me EULEX-in dhe të kërkonte nga ta që të merreshin me rastin e tij, mirëpo në secilin rast Sigurimi i EULEX-it në selinë e Misionit nuk i kishte lejuar atij që të kontaktonte me personelin e EULEX-it.

#### **Parashtresa nga ankuesi**

Ankuesi kishte pohuar se e drejta e tij për qasje në drejtësi i ishte mohuar dhe se të drejtat e tij ekonomike ishin shkelur nga ana e KFOR-it dhe policia e UNMIK-ut. Ai gjithashtu kishte pohuar se atij i ishte mohuar kontakti me personelin e EULEX-it në tri raste nga ana e Sigurimit të EULEX-it në selinë e Misionit.

#### **Vendimi i Panelit**

Paneli ka theksuar se ankesa e ka origjinën nga një incident që ka ndodhur në Prishtinë në qershor të vitit 2000, nën administrimin e UNMIK-ut dhe kishte të bënte me veprimet dhe/ose mosveprimet e KFOR-it dhe të policisë së UNMIK-ut. Duke e marrë parasysh rregullën 25 të rregullores së vet të punës, e cila e kufizon mandatin e Panelit në ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga ana e EULEX-it Kosovë, Paneli ka vërejtur se nuk kishte juridiksion për t'i shqyrtuar veprimet ose mosveprimet nga KFOR-i dhe/ose të UNMIK-ut.



Për më tepër, sipas rregullës 25, paragrafi 2 të rregullores së vet të punës, Paneli i shqyrton vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të drejtave të njeriut që kanë ndodhur pas datës 9 dhjetor 2008, në Kosovë, datë në të cilën EULEX-i u bë operacional.

#### **Vendimi dhe konstatimet**

Paneli vendosi se nuk kishte kompetencë për ta shqyrtuar ankesën meqë ajo nuk bënte pjesë në kuadër të juridiksionit të tij sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës dhe e shpalli ankesën të papranueshme.

#### **Lënda nr. 2015-07 [Dobrivoje Radovanovic kundër EULEX-it](#)**

##### **Neni 29 (d) i rregullores së vet të punës – Juridiksioni i Panelit**

#### **Faktet**

Faktet e kësaj lënde siç i ka paraqitur ankuesi ishin se në një datë të pasaktësuar në muajin mars 2015, ankuesi e kishte blerë një lopë dhe një viç prej G.R. Rrugës për në shtëpi, ai ishte ndaluar nga Policia e Kosovës, të cilët ia konfiskuan kafshët me dyshimin se ishin kontrabanduar në Kosovë, pasi ato nuk e kishin etiketën e nevojshme në vesh. Më 5 mars 2015, Zyra Rajonale e Doganës së Kosovës në Pejë kishte nxjerrë një vendim dhe i kishte konfiskuar lopën dhe viçin pasi ankuesi nuk e kishte dokumentacionin e duhur për blerjen e tyre. Ai po ashtu ishte urdhëruar që ta paguante një tarifë doganore dhe një gjobë në vlerën prej rreth 1,100.00 euro. Më 19 maj 2015, Dogana e Kosovës në Prishtinë e kishte vërtetuar këtë vendim.

#### **Parashtresa e ankuesit**

Duke mos e cituar ndonjë dispozitë të veçantë të dokumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ankuesi pohon se ishte dënuar padrejtësisht, në mungesë të tij dhe pa u dëgjuar.

#### **Vendimi i Panelit**

Paneli ka konstatuar se nuk është argumentuar, e as që është treguar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në çfarëdo mënyre në shkeljet e supozuara të drejtave të ankuesit. Vendimet për të cilat ai ankohet ishin lëshuar nga autoritetet e Doganës së Kosovës. Ai ka vazhduar duke thënë se çështjet e ngritura nga ankuesi nuk bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe të OPLAN-in e EULEX-it Kosovë.

#### **Vendimi dhe konstatimet**

Paneli vendosi njëzëri se nuk kishte kompetencë për ta shqyrtuar ankesën meqë ajo nuk bënte pjesë në kuadër të juridiksionit të tij sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës dhe e shpalli ankesën të papranueshme.

#### **Lënda nr. 2016-03, [Afrim Islami kundër EULEX-it Kosovë](#).**

##### **Rregulla 29 (d) jashtë juridiksionit të Panelit**

#### **Faktet**

Faktet e kësaj lënde siç janë paraqitur nga ankuesi janë se, më 27 gusht 2015, ankuesi kishte shkuar në zyrën e tij “Autoshkolla Abis” në rr. Agim Ramadani, nr.22/44, ku ishte konfrontuar nga zyrtarë të sigurimit nga Ndërmarrja Publike Banesore dhe nuk ishte lejuar që të hynte në zyrën e tij nga disa zyrtarë të sigurimit të NPB-së. Pastaj ankuesi kishte shkuar në Zyrat e NPB-së, në mënyrë që ta kuptonte pse nuk ishte lejuar që të hynte në zyrën e tij. Drejtori i NPB-së, N.K., e kishte informuar atë se ai duhej ta bënte pagesën e një borxhi prej 37.000 eurosh, e barasvlershme me parapagimin e qirasë për tre vjet. Ankuesi e kishte paguar borxhin e papaguar.

Kur ankuesi kishte shkuar në zyrën e tij më 2 shtator 2015 ai përsëri ishte konfrontuar nga zyrtarët e sigurimit të NPB-së. Ky incident pasoi në komunikimet me Drejtorin e NPB-së, me prokurorin publik të Kosovës, S.I. dhe me Policinë e Kosovës dhe me të gjithë këta ai ishte përpjekur që ta zgjidhte këtë çështje si dhe një varg të procedurave ligjore në gjykatat kosovare.

### **Parashtresa e ankuesit**

Pa e cituar ndonjë dispozitë të veçantë të instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nga përmbajtja e ankesës mund të thuhet që ankuesi pretendon se ishte arrestuar padrejtësisht nga policia (Neni 5 i Konventës), se e drejta e tij në jetën private ishte shkelur (neni 8 i Konventës), se i ishte mohuar e drejta e tij për zgjidhje efektive (neni 13 i Konventës) dhe se i ishte cenuar e drejta e tij për gëzim paqësor të pronës së tij (neni 1, Protokolli 1 i Konventës).

### **Vendimi i Panelit**

Para se të vlerësojë nëse do ta shqyrtojë apo jo ankesën në përputhje me rregullën 25, paragrafi 1 i RrP, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke i marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.

Paneli ka konstatuar se nuk është argumentuar, e as që është treguar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në çfarëdo mënyre në shkeljet e supozuara të drejtave të ankuesit. Ndërsa Paneli e pranoi se disa nga çështjet e ngritura, në veçanti paraburgimi i ankuesit, dështimi i autoriteteve për të vepruar me vendosmëri dhe në mënyrë efektive për ta ndaluar ngacmimin e mëtejshëm; dështimi për ta hetuar marrjen e një sasive të madhe parash, që të gjitha janë të një natyre të rëndë dhe shkaktojnë shqetësime të rënda, ato nuk bëjnë pjesë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë.

### **Vendimi dhe konstatimet**

Prandaj, Paneli vendosi njëzëri se nuk kishte kompetencë për ta shqyrtuar ankesën meqë ajo nuk bënte pjesë në kuadër të juridiksionit të tij sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës dhe e shpalli ankesën të papranueshme.

**Lënda nr. 2014-39 [Musli Hyseni kundër EULEX-it Kosovë](#).**

**Rregulla 29 bis – heqja e ankesës nga lista**

**Faktet**

Faktet e kësaj lënde siç janë paraqitur nga ankuesi mund të përmbliidhen si në vijim: akuesi ishte arrestuar më 5 nëntor 2013 në shtëpinë e tij në fshatin Bresalc, Gjilan nën dyshimin se kishte kryer disa vepra penale.

Me vendimin e datës 7 nëntor 2013, gjyqtari i procedurës paraprake në Gjykatën Themelore të Prishtinës kishte urdhëruar paraburgimin e ankuesit për një (1) muaj. Përmes disa urdhrave pasues të ngjashëm, ankuesi ishte mbajtur në paraburgim deri më 15 tetor 2014. Ankuesi ka paraqitur ankesën e tij në Panel nga Qendra e Paraburgimit në Prizren, më 13 tetor 2014.

### **Parashtresa e ankuesit**

Ankuesi ka pohuar se i janë shkelur të drejtat e tij për liri dhe siguri sipas nenit 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

### **Vendimi i Panelit**

Paneli ka theksuar se ankesa e ankuesit në thelb ka të bëjë me një numër vendimesh të gjyqtarit të procedurës paraprake për caktimin e vazhdimit të paraburgimit të tij për një periudhë kohore nga data 7 nëntor 2013 deri më 15 tetor 2014.

Më 7 mars 2016, Paneli ka komunikuar me ankuesin duke kërkuar nga ai informata në lidhje me faktet e çështjes. Paneli nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ankuesi për kërkesën e tij të datës 7 mars 2016. Pastaj, më 11 prill 2016, ankuesi e ka kontaktuar Sekretariatit e Panelit dhe i ka theksuar se ai nuk donte që të vazhdonte më procedurën e ankesës së tij dhe se ishte liruar nga paraburgimi.

Rregulla 29 e Rregullores së Punës parasheh që, në cilëndo fazë të procesit, Paneli mund të vendos që ta heqë ndonjë ankesë nga lista e lëndëve nëse rrethanat çojnë në përfundimin se parashtresuesi i ankesës nuk e ka ndërmend që ta vazhdojë procedurën e ankesës së tij.

Prandaj, Paneli ka vendosur që ta heq këtë ankesë nga lista e lëndëve, në pajtim me rregullën 29 të Rregullores së vet të Punës meqë ankuesi me gjasë nuk dëshironte që ta vazhdonte më lëndën e tij.

## **4.5. Vendimet për zbatimin e rekomandimeve të Panelit**

### **Lënda nr. 2012-22 [Desanka and Zoran Stanišić kundër EULEX-it](#)**

(Ky është vendim pasues i vendimit të mëparshëm të Panelit të datës 11 nëntor 2015 dhe rekomandimeve në të).

### **Historiku i lëndës**

Më 11 nëntor 2015, Paneli kishte marrë vendim në lidhje me ankesën e paraqitur nga ankuesi kundër EULEX-it dhe i ka dhënë një sërë rekomandimesh Shefit të EULEX-it Kosovë (ShM) në përputhje me rregullën 34 të rregullores së punës.

Në pjesët përkatëse në vendim thuhet:

Paneli gjeti se kishte shkelje të nenit 13 të Konventës; konstatoi se nuk ishte e nevojshme që të ta shqyrtonte çështjen sipas nenit 14 të Konventës dhe i kishte bërë rekomandimet në vijim për ShM:

Që ShM-ja duhej ta bënte një deklaratë ku e pranon se rrethanat e rastit kishin përbërë shkelje të drejtave të ankuesve që i ngarkohen veprimeve [dhe/ose mosveprimeve] të EULEX-it gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij;

Që ShM-ja duhej t'ua ofronte një kopje të këtij vendimi prokurorëve të EULEX-it pasi që kjo do t'i informonte prokurorët e EULEX-it rreth natyrës së përgjithshme të detyrimit të tyre për t'i përfshirë viktimat në hetimet e tyre dhe për t'u siguruar atyre arsyet e duhura rreth ndërprerjes së ndonjë hetimi në ndonjë rast të veçantë”.

### **Parashtresat nga ShM**

Më 15 dhjetor 2015, ShM e ka njoftuar Panelin rreth masave që ai i kishte marrë si përgjigje ndaj rekomandimeve të Panelit. ShM-ja e kishte shprehur zyrtarisht keqardhjen e tij për faktin se ankuesit nuk ishin të përfshirë mjaftueshëm në procedurat hetimore dhe se atyre nuk u ishin dhënë arsyet për përfundimin e hetimeve.

Në lidhje me rekomandimin e dytë të Panelit, ShM-ja ka treguar se vendimi i Panelit i datës 15 nëntor 2015 ju ishte shpërndarë prokurorëve të EULEX-it nga ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të EULEX-it. Në veçanti, prokurorëve të EULEX-it u ishte përkujtuar se në vendimet për pushimin e kallëzimeve penale duhet të përfshihet “një përmbledhje e shkurtë e arsyeve për atë vendim”. Për më tepër, nevoja dhe arsyeshmëria e intervistimit të personin që e ka dorëzuar kallëzimin penal duhet të vlerësohet në çdo rast para se të nxirret vendimi për pushimin e kallëzimit penal.

### **Vendimi pasues i Panelit**

Paneli i ka marrë parasysh hapat e ndërmarrë nga ShM-ja për zbatimin e rekomandimeve të tij. Paneli ka vërejtur se rekomandimi i parë i tij ishte për ShM-në që të bënte një deklaratë se e pranonte që rrethanat e rastit përbënin shkelje të drejtave të ankuesve që i ngarkohej misionit EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij. Në letrën e tij të datës 15 dhjetor 2015, Shefi i Misionit e ka shprehur keqardhjen e tij se ankuesit nuk ishin përfshirë sa duhej në procesin e hetimit dhe se atyre nuk u ishin dhënë arsye të mjaftueshme për përfundimin e këtij procesi.

Paneli ka gjetur se, ndërsa kjo përgjigje nuk e përfshinte plotësisht rekomandimin e Panelit, keqardhja e shprehur nga Shefi i EULEX-it Kosovë përbën pranim të nënkuptuar të mangësive në procesin hetimor që në njëfarë mënyre shkon drejt asaj që ankuesve u ofrohet lehtësim për shkeljen të drejtave të tyre.

Në vendimin e tij të datës 15 nëntor 2015, Paneli gjithashtu rekomandoi që ShM-ja duhej t'ua jepte kopjet e atij vendimi prokurorëve të EULEX-it përmes kanaleve përkatëse. Në letrën e tij, ShM-ja ka treguar se vendimi i Panelit në fakt u ishte shpërndarë prokurorëve të EULEX-it nga ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të EULEX-it. ShM-ja më tej ka treguar se prokurorëve të EULEX-it u ishin përkujtuar detyrimet e tyre për ta dhënë një përmbledhje të shkurtër të arsyeve të tyre kur e hedhin poshtë kallëzimin penal dhe se arsyeshmëria e intervistimit të personit që e ka parashtruar kallëzimin penal duhet të vlerësohet në secilin rast. Paneli është i bindur se këta hapa janë në përputhje me rekomandimin e dhënë nga Paneli dhe e përmbushin plotësisht atë.

Pasi e ka shqyrtuar informacionin e dhënë nga ShM-ja, Paneli njëzëri ka vendosur se ShM-ja i kishte zbatuar rekomandimet e Panelit dhe ka vendosur më tej që ta mbyll shqyrtimin e kësaj lënde.

## Lënda nr. 2014-32, L.O. kundër EULEX-it

### Historiku i lëndës

Me 11 nëntor 2015, Paneli ka marrë vendimin në lidhje me ankesën e paraqitur nga L.O. kundër EULEX-it-i Kosovë dhe ka bërë një sërë rekomandimesh për Shefin e Misionit (ShM) në përputhje me rregullën 34 të Rregullores së Punës. Ish-ShM-ja kishte deklaruar si në vijim në përgjigjen e tij ndaj rekomandimeve të Panelit me anë të letrës së datës 29 prill 2016. Në vendim thuhet si në vijim: The former HoM stated as follows in his response to the recommendations of the Panel by letter on 29 April, 2016:

“Pasi që rekomandimet e Panelit kanë të bëjnë me masat që janë në dispozicion të CPCC-së [Kapacitete të Administrimit dhe Planifikimit Civil], disa institucioneve të BE-së, si dhe shteteve anëtare, unë e kam informuar CPCC-në dhe shtetet kontribuuese lidhur me vendimin dhe gjetjet e Panelit” përmes Komandantit të Operacioneve Civile, dhe në këtë mënyrë e konsideroj që rekomandimi është zbatuar”.

### Vendimi pasues i Panelit

Gjatë vlerësimit të tij të përgjigjes së ish-ShM-së, Paneli ka konstatuar se, fillimisht dhe në kundërshtim me atë që duket se e sugjeron deklarata e mësipërme e ish-ShM-së, përgjegjësia për zbatimin e rekomandimeve të Panelit bie tërësisht dhe ekskluzivisht mbi ShM-në, e jo mbi CPCC-në, dhe as mbi shtetet anëtare.

Së dyti, përderisa ish-ShM-ja kishte theksuar në letrën e tij se ai e kishte informuar CPCC-në dhe shtetet kontribuuese lidhur me vendimin dhe rekomandimet e Panelit, ai nuk thotë asgjë për përprjekjet e tij, nëse ka pasur ndonjë, për t’i zbatuar rekomandimet e Panelit.

Së fundi dhe në kundërshtim me supozimin e qartë të ish-ShM-së, përgjegjësia për të vendosur nëse rekomandimet e Panelit janë zbatuar apo jo i takon në tërësi Panelit. Paneli në këtë drejtim ka theksuar se përderisa rekomandimet e tij nuk janë ligjërish të detyrueshme, është thelbësore për kredibilitetin dhe legjitimitetin e EULEX-it Kosovë, si Mision i sundimit të ligjit, që ai duhet me vendosmëri dhe në mënyrë të besueshme ta demonstrojë përkushtimin e tij për zbatimin efektiv të drejtave të njeriut duke siguruar që veprimet e tij në çdo kohë të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në këto rrethana.

Prandaj, Paneli njëzëri ka deklaruar se ish-ShM-ja nuk i ka zbatuar rekomandimet e tij dhe i ka bërë thirrje ShM të re që t’i merr parasysh dhe t’i zbatojë plotësisht secilin prej rekomandimeve dhe me kohë ta njoftojë Panelin lidhur me veprimet e ndërmarra. Përfundimisht, Paneli ka vendosur që ta mbajë rastin.

## 5. Aktivitetet e Panelit

### 5.1. Takimet e Panelit

**Shërbimi i Jashtëm Evropian (EEAS) dhe Komisioni për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave, (CivCom), Bruksel.**

Paneli i përfaqësuar nga Kryesuesja e Panelit, znj. Magda Mierzevska dhe Zyrtari i lartë ligjor, John J Ryan, kanë marrë pjesë në një numër të takimeve me znj. Jana Kaliminova, Kryesuese e CivCom; z. Bert Versmessen, Zëvendës Komandant i Operacioneve Civile dhe Shef i Kabinetit, Komisioni për

Kapacitetet e Planifikimit dhe Operacioneve Civile, (CPCC), EEAS, z. Alexis Hupin, Zyrtar i diskut për Kosovën, Shërbimi për Veprim të Jashtëm i Bashkimit Evropian, (EEAS); si dhe me përfaqësuesit e vendeve anëtare të Grupit Punues CivCom, në Bruksel më 28 shtator, 2016.

Pikat e rendit të ditës së takimit kanë përfshirë, mes tjerash, diskutime për zbatimin e rekomandimeve të Panelit nga ana e Shefit të Misionit; kompensimin dhe restitucionin për viktimat; përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Rregulloren e punës së Panelit dhe procedurat pasuese; trajnimin hyrës, mësimet e nxjerra dhe trashëgiminë e Panelit. Po ashtu, Kryesuesja e Panelit e paraqiti një raport lidhur me Panelin për përfaqësuesit e vendeve anëtare të CivCom dhe vazhduan bashkëbisedimin me pyetje dhe përgjigje me ta.

### **Takimi me Shefen e Misionit EULEX-i Kosovë**

Paneli u takua me znj. Alexandra Papadopoulou, Shefja e re e Misionit, e shoqëruar nga znj. Elaine A Pappos, znj. Marianne Fennema dhe Znj. Heidi Lempio në ndërtesën e PSHDNJ më 17 tetor 2016.

### **Përfaqësuesja Speciale e Bashkimit Evropian në Kosovë**

Po ashtu, Paneli u takua me znj. Nataliya Apostolova, Përfaqësuese Speciale e Bashkimit Evropian (PSBE) i cila shoqërohej nga Shaban Murturi, Selia e PSBE-së, Rruga e Kosovës Nr. 1, Prishtinë më 17 tetor 2016.

Gjatë diskutimeve u ngritën këto çështje: përputhshmëria e EULEX-it Kosovë me rekomandimet e Panelit, numri i lëndëve të Panelit dhe natyra e ankesave të cilat janë bërë në Panel, domosdoshmërinë për mekanizma të llogaridhënies për të drejtat e njeriut në misionet me kompetenca ekzekutive të Politikave të Përbashkëta të Sigurisë dhe Mbrojtjes, si dhe trashëguesve të EULEX-it Kosovë dhe të Panelit. Në përfundim, PSBE tha se ajo i mirëpret takimet e radhës në të ardhmen me Panelin.

## **5.2. Fushata informuese e vitit 2016**

Paneli ka vazhduar me zbatimin e fushatës së tij për informimin publik për ta informuar opinionin e gjerë në lidhje me Panelin. Fushata informuese është kryer në përputhje me Dokumentin e Konceptit të Llogaridhënies i datës 29 tetor 2009, i cili ndër të tjera në paragrafin E thekson se "... EULEX-i Kosovë do të sigurojë shpërndarje të duhur të informacionit publik rreth Panelit dhe punës së tij ...".

Komandanti i Operacioneve Civile, në udhëzimin e tij të datës 13 nëntor 2009 në lidhje me Panelin, ka deklaruar se Udhërrëfyesi për Kapacitetet e Planifikimit dhe Operacioneve Civile duhet të përfshijë "...përgatitjen e një fushate gjithëpërfshirëse të marrëdhënies me publikun".

Përqendrimi kryesor i fushatës informuese gjatë këtij viti ka qenë tek OJQ-të dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Si pjesë e kësaj strategjie, Paneli dhe Sekretariati i kanë shtuar aktivitetet e tyre në veri të Mitrovicës në përpjekje për ta rritur nivelin e dukshmërisë së tij në atë zonë.

Siç është thënë në Raportet Vjetore të mëparshme, vazhdon të ketë mungesë të përgjithshme të njohurive dhe informatave për Panelin, për mandatin dhe për punën e tij në tërë hapësirën ku vepron EULEX-i. Kjo gjë është më shumë e theksuar në zonat rurale.

Në këtë kontekst, Paneli dhe Sekretariati do të përqendrojnë më shumë aktivitete sensibilizuese në këto zona rurale. Vazhdimi i fushatës së reklamave në TV dhe radio të cilat ishin realizuar më parë

nga Paneli do ta ndihmojë Panelin në përpjekjet e tij për të pasur qasje te popullata e përgjithshme urbane dhe rurale.

### **5.3. Trajnimi hyrës**

Sekretariati e ka vazhduar pjesëmarrjen e tij në programin e trajnimit hyrës të EULEX-it për pjesëtarët e rinj të personelit të EULEX-it. Format i tij përbëhet nga një prezantim për Panelin me një kohë të caktuar për pyetje dhe përgjigje. Ky proces është shumë i dobishëm për t'i informuar pjesëtarët e ardhshëm të personelit për mandatin e Panelit, për ta nënvizuar edhe më shumë rëndësinë e respektimit të drejtave të njeriut për EULEX-in Kosovë, si dhe për ta ngritur rëndësinë e Panelit tek personeli i EULEX-it në zonën ku vepron misioni EULEX-i Kosovë.

Paneli e konsideron këtë si një element me rëndësi të veçantë i fushatës së tij për informimin publik dhe që i ofron Panelit një mundësi për të siguruar që të gjithë pjesëtarët e ri të personelit të EULEX të jenë të informuar lidhur me obligimin e tyre për t'i respektuar standardet përkatëse të drejtave të njeriut gjatë kryerjes së funksioneve të tyre, si dhe implikimeve në llogaridhënie në rastin e shkeljeve të mundshme të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve ekzekutive të tyre.

### **5.4. Faqja e internetit e PSHDNJ**

Sekretariati e mirëmban faqen e internetit të Panelit: [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu). Kjo faqe përmban informata lidhur me mandatin, procedurat dhe punën e Panelit, si dhe informata të përditësuara rregullisht për vendimet e Panelit, si dhe listën e lëndëve që janë ende të pazgjidhura dhe ato të përfunduara. Tabela e jurisprudencës së Panelit ofron qasje të lehtë në të sikundër që është edhe praktika gjyqësore në rritje e tij e ndarë sipas lëndëve, në bazë të pranueshmërisë dhe përmbajtjes. Ajo është krijuar, mes tjerash, për të siguruar qasje të gatshme dhe të lehtë në praktikën gjyqësore të Panelit për ankuesit, juristët dhe për opinionin e gjerë: (<http://www.hrrp.eu/jurisprudence.php>).

Faqja e internetit gjithashtu ofron informacione për:

Standardet e aplikueshme të drejtave të njeriut: (<http://www.hrrp.eu/relevant-rights.php>);

Formularët dhe udhëzimet për parashtrimin e ankesave: (<http://hrrp.eu/filing%20complaints.php>);

Po ashtu, Paneli e ka profilin e tij në Facebook: Human Rights Review Panel;

Informatat e mësipërme janë në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

## **6. Paneli dhe Sekretariati**

### **6.1. Anëtarët e Panelit**

Paneli përbëhet prej katër anëtarëve; dy anëtarë të jashtëm ku përfshihet kryesuesja e Panelit, si dhe anëtarin e Panelit nga EULEX-i si dhe zëvendësin e anëtarit të Panelit nga EULEX-i, dhe që të dy janë gjyqtarë të EULEX-it

#### **Kryesuesja**

**Znj. Magda Mierzevska**, shtetase e Polonisë, ka mbaruar Provimin Shtetëror të Polonisë për poste gjyqësore në vitin 1982. Ajo u pranua në Odën e Këshilltarëve Juridik të Gdanskut në vitin 1989 dhe

ka arritur shkallën e magjistrisë të drejtësisë (LLM) në të Drejtën e Bashkimit Evropian në Universitetin Leicester në vitin 2005.

Ajo u emërua juriste rreth lëndëve në Sekretariatën e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg në vitin 1993. Pastaj, nga viti 1998 ajo është punësuar si juriste në Sekretariatën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, Francë. Ajo ka përvojë të gjerë ndërkombëtare të trajnimit në çështje të ndryshme thelbësore dhe procedurale të drejtave të njeriut.

Znj. Mierzewska është emëruar anëtare e Panelit të EULEX-it për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nga ushtruesi i detyrës së Shefit të Misionit EULEX më 4 maj 2010. Ajo u zgjodh Kryesuese e Panelit më 3 tetor 2012.

Publikimet e shumta akademike të znj. Mierzewska përfshijnë: *Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut: Dhjetë vite pas Ratifikimit*, Zyra për Informim e Këshillit të Evropës në Varshavë, 2004; *Dhjetë vjet më pas: Popullariteti i Konventës në Poloni* (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi i 4, 2004; *Dhjetë vjet më pas: Praktika gjyqësore polake voluminoze dhe interesante* (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi 5, 2004; *Standardet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet lidhur me shpronësimet dhe aplikimin e tyre për kërkesat pronësore gjermane*, Instituti Polak për Marrëdhënie ndërkombëtare, 2005; *Procesi i pranimit të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në Poloni dhe Sllovakia në: Pranimi i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut*, botimet. H. Keller, A. Stone-Sweet, Oxford University Press, maj 2008; *Konsistenca e praktikës gjyqësore si çështje e të drejtave të njeriut në jurisprudencën e Gjykatës evropiane të të drejtave të njeriut*, në: *Cohérence et impact de la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme*, Liber amicorum Vincent Berger, 2013. Ajo është bashkë autore me J. Krzyzanowski, Według ojca, według córki e (Sipas babait, sipas vajzës), e cila ka marrë një çmim për librin më të mirë historik të botuar në Poloni në vitin 2010.

## **Anëtarët**

### **Prof Dr Guénael Mettraux**

Dr. Guénaël Mettraux, shtetas i Zvicrës, ka diplomuar për juridik (licence en droit) në Universitetin e Lozanës (Zvicër), ka magjstruar për juridik (LLM) në të drejtën ndërkombëtare nga Kolegji Universitar i Londrës dhe ka doktoruar në Shkollën londineze të ekonomisë dhe shkencave politike.

Ai punon si avokat mbrojtës dhe konsulent në gjykatat penale ndërkombëtare (ICTY, ICC, STL dhe ECCC). Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, ai ka përfaqësuar disa udhëheqës të lartë ushtarak dhe civil, të akuzuar për krime ndërkombëtare. Ai ka këshilluar qeveri dhe OJQ rreth çështjeve të ndryshme lidhur me regjimet rregullatore, gjykimet penale, ligjet dhe drejtësinë tranzicionale. Dr. Mettraux tani është profesor në Universitetin e Amsterdamid (Holandë) dhe ligjërues mysafir në Universitetin e Friburgut (Zvicër).

Ai ka bërë publikime të shumta në fushën e së drejtës ndërkombëtare. Puna e tij shkencore përfshinë tri libra: *International Crimes and the ad hoc Tribunals (Krimet Ndërkombëtare dhe Tribunalet ad hoc)* (Oxford University Press, 2005), *Perspectives on the Nuremberg Trial (Perspektiva rreth Gjyimit të Nyrembergut)* (Oxford University Press, 2008) dhe *The Law of Command Responsibility (Ligji mbi përgjegjësinë komanduese)* (Oxford University Press, 2009), e cila ka marrë çmimin Lieber nga *American Society of International Law (Shoqata Amerikane e së*



*Drejtës Ndërkombëtare*). Dr. Mettraux-i është anëtar i Komisionit Redaktues të *Revistës të së Drejtës Ndërkombëtare* dhe i Këshillit Redaktues të *Revistës të së Drejtës Penale Ndërkombëtare*.

Dr Guenael Mettraux është emëruar gjyqtar ndërkombëtar në Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë Speciale, Hagë, Holandë, më 7 shkurt, 2017.

### **Znj. Elka Ermenkova**

Znj. Elka Filcheva-Ermenkova, shtetase e Bullgarisë ka studiuar për drejtësi në Universitetin e Blagoevgrad-it në Bullgari, ku ka diplomuar në vitin 1997. Pas përfundimit të stazhit të saj pas-universitar, në tetor 1998 ajo është emëruar gjyqtare e re në Gjykatën e Qarkut në Blagoevgrad në një panel të ankimit, ku nën mbikëqyrjen e dy gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut ajo ka kryesuar lëndë në të gjitha fushat e të drejtës: civile, penale dhe administrative. Në vitin 2001 ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën Rajonale në Blagoevgrad ku ka kryesuar çështjet civile dhe penale. Në vitin 2003 ajo është emëruar kryetare e Gjykatës Rajonale në Blagoevgrad.

Në vitin 2004, ajo është emëruar gjyqtare e Gjykatës së Qarkut në shkallën e dytë, ndërsa ka punuar edhe si gjyqtare e shkallës së parë dhe gjyqtare e apelit në çështjet civile dhe penale, me theks kryesor në çështjet civile. Si gjyqtare e apelit ajo ka gjykuar ankesat kundër aktgjykimeve të pesë gjykatave rajonale në fushën penale dhe civile. Në janar të vitit 2008, ajo është dërguar në Këshillin e Bashkimit Evropian (BE), në Komisionin për Kapacitetet e Planifikimit dhe Operacioneve Civile (CPCC) si këshilltare për sundim të ligjit, ku ka punuar deri në janar të vitit 2012. Në këtë cilësi ajo e ka ndihmuar Sekretariatit e Këshillit (më vonë Shërbimi për Veprim të Jashtëm i Bashkimit Evropian (EEAS), për planifikimin dhe realizimin e misioneve civile për menaxhimin e krizave duke ofruar ekspertizën e saj në sundimin e ligjit.

Në janar të vitit 2012 ajo është punësuar nga EULEX-i Kosovë si gjyqtare ndërkombëtar në Panelin për Ankesa, për ankesat kundër vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës ku ka vendosur për kontestet pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur në Kosovë 1998/1999. Në gusht 2014 ajo u caktua gjyqtare penale ndërkombëtare në Gjykatën Supreme të Kosovës me mandat për rastet penale që kanë të bëjnë me krimet e luftës, krimin e organizuar dhe krime të tjera të rënda.

Znj. Ermenkova është emëruar anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në janar të vitit 2013, ndërsa në nëntor të vitit 2016 ajo u emërua anëtare e Panelit nga EULEX-i. Ajo gjatë karrierës profesionale të saj ka fituar një përvojë të madhe dhe të gjerë në ligjet për të drejtat e njeriut, veçanërisht në të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtën për liri, lirinë e të shprehurit, ndalimin e diskriminimit dhe të drejtën në pronë.

### **Anëtarja zëvendësuese**

#### **Znj. Anna Bednarek**

Anna Bednarek u diplomua në Universitetin e Gdanskut, Poloni dhe fitoi titullin Magjistër për juridik (LLM) në vitin 1994, kurse provimin shtetëror polak për pozita gjyqësore e kreu në vitin 1997. Studimet post-diplomë si gjyqtare civiliste i kreu në Akademinë e Shkencave të Polonisë, Varshavë, si dhe studimet post-diplomë në Institutin e Shkencave të Vendeve në Zhvillim në Universitetin e Varshavës në vitet 2008/2009. Znj. Bednarek ka punuar si Eksperte e Lartë në Zyrën e Përfaqësuesit të Qeverisë së Polonisë në Komisionin Evropian, EULEX-i Kosovë dhe Gjykatën për të Drejtat e Njeriut, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicave Kombëtare, Departamenti Ligjor dhe i Traktateve në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Polonisë, Varshavë. Po ashtu, ajo ka qenë

anëtare e Delegacionit të Qeverisë së Polonisë në Sesionin e 54-t për të Drejtat e Njeriut në Komisionin e Kombeve të Bashkuara për EULEX-i Kosovë.

Ajo u emërua gjyqtare në Gjykatën e Qarkut të Varshavës ndërmjet muajit qershor 1998 dhe vitit 2001. Ajo pastaj ishte punësuar si Konsulle në Ambasadën e Polonisë, Romë, Itali prej vitit 2001 deri 2007. Ajo ka punuar si gjyqtare në Gjykatën e Qarkut të Varshavës prej prillit 2007 deri në janar 2009. Pastaj ajo u emërua gjyqtare e EULEX-it në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit ku ka punuar deri në janar 2009.

Znj. Bednarek u emërua anëtare zëvendësuese e Panelit të EULEX-it për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) nga Shefi i Misionit EULEX-i Kosovë më 25 maj 2011 dhe ishte caktuar anëtare zëvendësuese e Panelit nga Shefi i Misionit EULEX-i Kosovë më 12 korrik 2011. Pas kësaj, znj. Bednarek ka punuar si gjyqtare në Gjykatën e Qarkut të Varshavës janarit 2012 deri në shtator 2015. Ajo ka marrë pjesë si bashkë-autore dhe konsulente në një projekt të organizuar nga Fondacioni Helsinki në Poloni që kishte për qëllim publikimin e një Udhëzuesit për gjyqtarë dhe prokurorë me titull "Trajtimi i barabartë i palëve në procedurë" në vitin 2015. Ky Udhëzues ishte botuar në shkurt 2016. Ndërmjet shtatorit 2014 dhe qershorit 2015, znj. Bednarek ka bashkë-vepruar me Institutin e Evropës Qendrore dhe Lindore për Iniciativa Ligjore në Pragë, Republika e Çekisë, në një projekt me qëllim publikimin e "Udhëzuesit gjyqësor për pavarësinë, paanësinë dhe integritetin e drejtësisë: Përmbledhje tematike e standardeve, politikave dhe praktikave më të mira ndërkombëtare". Ky Udhëzues u botua në qershor 2015.

Në prill të vitit 2015, ajo ishte ftuar nga Instituti CEELI, Pragë për të marrë pjesë në projektin "Gjykimi në shoqërinë demokratike", ku ajo ishte përfshirë si trajnuese e kryetarëve të gjykatave të Tunizisë për standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut. Në tetor 2013, znj. Bednarek mori pjesë si fasilituese në një projekt të realizuar nga Fondacioni për Bashkëpunim Polako-Ukrainas (PAUCI) nga Varshava dhe ka mbajtur seminare në universitetet e Ukrainës (Lvov, Kharkov, Donetsk) në temën: "Fuqizimi i funksionit të kontrollit të gjyqësorit si ekuilibër ndërmjet autoriteteve në Ukrainë".

Në vitin 2008 ajo mori pjesë si trajnuese e projektit "Trafikimi i njerëzve – Trajnim për gjyqtarë" i paraparë për ta luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe skllavërinë. Ky projekt ishte organizuar nga Fondacioni "La Strada", Varshavë, Poloni në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Polonisë dhe me Ambasadën Britanike në Varshavë. Po ashtu, znj. Bednarek ka punuar për Amnesty International si menaxhere e projektit të një projekti në Poloni për publikimin e një Doracaku Arsimor për të Drejtat e Njeriut.

Znj. Bednarek është caktuar anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të njeriut nga Shefja e Misionit EULEX-i Kosovë 14 tetor, 2016.

## **6.2. Sekretariati**

Sekretariati i Panelit përbëhet prej një zyrtari të lartë ligjor, një zyrtari ligjor dhe dy përkthyes.

### **Z. John J. Ryan**

John J. Ryan, shtetas i Irlandës dhe ish-oficer ushtarak, ka diplomuar në juridik me titullin Bachelor (Hons) për Drejtësi dhe Studime Evropiane nga Universiteti i Limerick-it, Irlandë dhe ka diplomë pasuniversitare si avokat nga Shoqata e Avokatëve të Irlandës. Ai ka punuar si avokat në Stephen MacKenzie dhe Co. Solicitors në Dublin, Irlandë. Ai ka shërbyer në Kombet e Bashkuara në Liban,

Siri, Izrael, Kamboxhia, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Timor Lindor, Nepal, Kosovë dhe si konsulent i Komisionit Evropian në Kinë. Para se të merrte detyrën e tij të tanishme, kishte punuar në UNMIK, *ndër të tjera* si administrator në Komunën e Zveçanit në regjionin e Mitrovicës, shef i Divizionit për Mbështetje Gjqësore Ndërkombëtare - Departamenti i Drejtësisë, zëvendës këshilltar ligjor, Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara (O/PSSP) - UNMIK, dhe zyrtar ekzekutiv, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (O/PSSP). Në pozitën e tanishme si zyrtar i lartë ligjor dhe shef i Sekretariatit, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i BE-së ai është emëruar në prill 2010. Artikujt e tij rreth Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, EULEX-i Kosovë, janë botuar në Revistën vjetore të Forcave të Mbrojtjes të Irlandës në vitin 2010 dhe 2015.

### **Znj. Noora Aarnio**

Znj. Noora Aarnio, shtetase e Finlandës, ka diplomuar për juridik me titullin Magjistër (Master of Laws) në Universitetin e Helsinkit, Finlandë, në vitin 2004. Ajo e ka kryer një trajnim njëvjeçar për gjyqtare në Gjykatën e Qarkut të Lohja Finlandë, në vitin 2005, në mënyrë që të kualifikohet për të punuar si gjyqtare. Prej muajit janar 2006 deri në shkurt 2010 ajo ka qenë e punësuar si ndihmës gjyqtare, fillimisht në Gjykatën e Sigurimeve dhe pastaj në Gjykatën e Apelit në Helsinki. Mëpas, ajo ka punuar si Zyrtare Ligjore në EULEX, fillimisht për një vit në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë e pastaj edhe dy vjet në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ajo u kthye në Finlandë për të punuar si gjyqtare në Gjykatën e Qarkut në Pirkanmaa ku punoi prej muajit gusht 2013 deri në tetor 2014. Pas kësaj, ajo punoi si Këshilltare Ligjore në Njësinë Ndërkombëtare të Departamentit të Administratës Gjqësore në Ministrinë e Drejtësisë të Finlandës prej muajit tetor 2014 deri në dhjetor 2015. Ajo u kthye në EULEX në prill 2016 kur punoi si Zyrtare Ligjore në Gjykatën e Apelit/Gjykatën Supreme të Kosovës deri në nëntor 2016 kur u emërua Zyrtare Ligjore në Sekretariatit e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut.

### **Znj. Katica Kovacevic**

Znj. Katica Kovacevic, serbe e Kosovës, ka qenë e punësuar më parë si asistente administrative/gjuhësore (serbisht/anglisht) në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm nga maji i vitit 2003 deri në dhjetor të vitit 2008 dhe si asistente gjuhësore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nga janari i vitit 2009 deri në nëntor të vitit 2010. Ajo e filloi punën si përkthyes në Sekretariatit e Panelit në dhjetor të vitit 2010.

### **Z. Kushtrim Xhaferi**

**Z. Kushtrim Xhaferi**, shqiptar i Kosovës, ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës, Kosovë, në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze. Ai më parë ka punuar si përkthyes (shqip/anglisht) në Korporatën Energjetike të Kosovës nga shkurti i vitit 2004 deri në janar të vitit 2009, e më pas si asistent gjuhësor në Komponentin e Policisë së EULEX-it. Ai punon si përkthyes në Sekretariat që nga shtatori i vitit 2010.

## **6.3. Ish-personeli i Panelit dhe Sekretariatit**

Pjesëtarët e mëposhtëm të personelit i kanë përfunduar angazhimet e tyre në Panel apo Sekretariat gjatë vitit 2016.

## **Dr. Katja Dominik**

Dr. Katja Dominik, shtetase e Gjermanisë, ka studiuar për drejtësi dhe gjuhët sllave në Universitetin e Goettingen-it në Gjermani, ku ka diplomuar në vitin 1996.

Dr. Dominik ka fituar bursë për pas-diplomë, dhe i ka përfunduar studimet për aspektet ligjore të shpërbërjes së shtetit të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në Zagreb, Kroaci, në vitin 1998/99. Disertacioni i saj për këtë temë ishte botuar në vitin 2001.

Nga viti 2000 deri në vitin 2002 ajo ka punuar për periudha të ndryshme si nëpunëse ligjore në Gjykatën e Lartë Rajonale në Dyseldorf dhe gjithashtu në zyrën e avokatisë e specializuar në ligjin për azil. Në vitin 2002 ajo ishte punësuar nga Ministria Federale Gjermane e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik në Bon, ku kishte punuar në Sektorin për politikën zhvillimore evropiane. Në këtë cilësi, ajo ka hulumtuar dhe përpiluar tekste dhe fjalime për konferenca ndërkombëtare për ndihmë zhvillimore në Bruksel dhe Bon, ku ajo gjithashtu në disa raste e ka përfaqësuar qeverinë gjermane.

Në tetor të vitit 2002, Dr. Dominik është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Qarkut në Dyseldorf, ku është specializuar në fusha të ndryshme të drejtës penale. Më pas, ajo ishte bërë zëvendës kryetare në dhomën penale të Gjykatës së Qarkut për krime të rënda kapitale dhe krime ekonomike.

Dr. Dominik është emëruar gjyqtare ndërkombëtare në EULEX-i Kosovë në tetor të vitit 2011, ku më pas është caktuar në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, ku merret me raste të krimeve të luftës të profilit të lartë, vrasje, korrupsion dhe trafikim të qenieve njerëzore. Shefi i misionit EULEX e ka emëruar dr. Dominik-un anëtare të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Evropian në janar të vitit 2013.

## **Z Paul Landers**

Z. Paul Landers, shtetas i Irlandës, është avokat që ka diplomuar në Honourable Society of King's Inns, Irlandë. Ai ishte ftuar në Odën e Avokatëve të Republikës së Irlandës. Ai gjithashtu ka diplomë pasuniversitare në të drejtat e njeriut dhe drejtësi penale në Universitetin Queen's University në Belfast, Irlandë e Veriut. Ai është ish-anëtar i Garda Síochána (Policia irlandeze) ku ka shërbyer për 15 vjet në Njësinë Speciale Detektive. Më pas, ai mori postin e këshilltarit ligjor dhe për të drejta të njeriut në Garda Síochána. Z. Landers më parë ka punuar si zyrtar ligjor në Zyrën për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Ligjore të EULEX-it. Para se ta merrte detyrën e tij të tashme, ai ishte i punësuar në Misionin për sundimin e ligjit në gadishullin verilindor të Afrikës, si shef i shtyllës së Policisë me përgjegjësi në Xhibuti, Somali, Somaliland, Puntland, Sejshell dhe Tanzani. Ai ishte emëruar zyrtar ligjor i Sekretariatit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të BE-së në gusht 2015.

## **Znj. Joanna Marszalik**

Znj. Joanna Marszalik, shtetase e Polonisë, ka diplomuar për Drejtësi në nivelin Master nga Universiteti i Jagiellonian-it në Krakow, Poloni. Për pesë vite ajo ka punuar juriste në Sekretarinë e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut në Strasburg, Francë. Më pas ajo ishte menaxhere e projektit të Këshillit të Evropës për ndërtimin e institucioneve "Mbështetja për Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë" dhe udhëheqëse ekipi e projektit të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian "Transparenca dhe Efikasiteti i Sistemit Gjyqësor në Ukrainë", i cili i ka mbështetur reformat e sistemit gjyqësor të Ukrainës. Ajo iu bashkua misionit të OSBE-së në Kosovë në dhjetor të vitit 2010, ku ka punuar si zyrtare e lartë e të drejtave të njeriut, duke mbikëqyrur

Qendrën Rajonale në Prishtinë. Ajo u emërua si zyrtare ligjore në Sekretariatit e Panelit në prill të vitit 2012.

## **Znj. Shpresa Gosalci**

Znj. Shpresa Gosalci, shqiptare e Kosovës, ka diplomuar Master për marketing biznesi dhe menaxhment nga Universiteti AAB, Prishtinë. Ajo ishte punësuar si përkthyes (shqip/serbisht/anglisht) në KFOR nga korriku i vitit 1999 deri në qershor të vitit 2000, si dhe si asistente administrative/gjuhësore në Zyrën për Informim Publik dhe Media të Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut nga qershori i vitit 2000 deri në mars të vitit 2009. Ajo e ka filluar punën e saj si asistente administrative/gjuhësore në Sekretariatit e Panelit në korrik të vitit 2010.

## **7. Çështjet operative dhe administrative**

### **7.1. Buxheti**

Në vitin 2016, si në vitet e mëparshme Panelit i është ndarë një buxhet i veçantë për fushatën informuese dhe materiale promovuese. Ky është një hap i mirëpritur, i cili i mundëson Panelit të marrë vendimet e veta për realizimin e fushatës së informimit publik, veçanërisht në transmetimet televizive ose në radio, pa mbështetje prej burimeve nga EULEX-i Kosovë.

Megjithatë, burimet buxhetore plotësuese do t'i ndihmojnë në masë të madhe Panelit gjatë punës së tij të përditshme. Kjo do ta rrisë edhe më tej pavarësinë e vërtetë dhe të perceptuar të Panelit dhe kësaj do ta shtojë më tej besueshmërinë e EULEX-it Kosovë në lidhje me përkushtimin e tij për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

### **7.2. Burimet njerëzore**

Sekretariati i Panelit ishte ndikuar negativisht në aspektin e personelit në vitin 2016. Ky Panel e ka humbur një pozitë të zyrtarit ligjor gjatë ri-konfigurimit të personelit të EULEX-it dhe një pozitë të asistentit administrativ/gjuhësor. Paneli është dashur që të punojë me vetëm një zyrtar ligjor gjatë tre muajve të fundit të vitit kurse detyrat e asistentes administrative është dashur që, përveç detyrave të tyre të rregullta, të kryhen nga dy përkthyesit.

Përveç kësaj, znj. Katja Dominik, anëtare e Panelit nga EULEX-i Kosovë dhe gjyqtare penaliste në Gjykatën Themelore të Mitrovicës ka dhënë dorëheqje nga pozita e saj si anëtare e Panelit nga EULEX-i Kosovë më 14 qershor 2016 në mënyrë që të përqendrohej në përgjegjësitë e shtuara të saj në detyrën e re si Shefe e Sektorit Ekzekutiv.

Zj Elka Ermenkova, gjyqtare penaliste në Gjykatën Supreme/Gjykatën e Apelit në Prishtinë dhe anëtare zëvendësuese e Panelit nga EULEX-i Kosovë u emërua më 14 tetor 2016 anëtare e Panelit nga EULEX-i Kosovë për ta zëvendësuar znj. Dominik.

Znj. Anna Bednarek, gjyqtare e apelit në Panelin për Ankesa të Agjencisë Kosovare të Pronës në Prishtinë u emërua më më 14 tetor 2016 anëtare zëvendësuese e Panelit nga EULEX-i Kosovë.

Znj. Magda Mierzewska, Kryesuesja e Panelit shfrytëzon rastin që ta falënderojë Znj. Dominik për kontributin profesional të jashtëzakonshëm të saj në punën e Panelit gjatë më shumë se katër (4) viteve të punës së saj aty dhe i dëshiron shumë suksese në detyrën e tanishme të saj dhe në karrierën e saj të ardhshme.

Po ashtu, ajo dëshiron ta shfrytëzojë këtë rast që ta përgëzojë znj. Ermenkova dhe znj. Bednarek për emërimet përkatëse të tyre në cilësitë përkatëse të tyre në Panel dhe u uron suksese në punën e tyre.

Ajo, po ashtu e shfrytëzon këtë mundësi për t'i shprehur mirëseardhje zyrtares së re ligjore të Panelit, Noora Aarnio, zyrtare ligjore në Gjykatën e Apelit/Gjykata Supreme në detyrën e saj të re në Panel dhe i uron suksese në këtë pozitë të re të saj.

## **8. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut – Përfundimi i mandatit**

### **Themelimi**

Siç është theksuar në paragrafin 4.2 më sipër, Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), është themeluar me anë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 10 qershor 1999. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut (PKDNJ) është krijuar nga UNMIK-u në bazë të Rregullores Nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Mandati i PKDNJ-së ishte shqyrtimi i ankesave të cilitdo personi apo grupi individësh që pretendojnë se kanë qenë viktimë të shkeljes së të drejtave të tyre të njeriut nga ana e UNMIK-ut. PKDNJ e ka nisur punën e tij me sesionin inaugurues të tij prej 12 deri 16 nëntor 2007. Ai i ka shqyrtuar rreth 527 ankesa dhe ka konstatuar se UNMIK-u kishte bërë shkelje të drejtave të njeriut në 335 prej këtyre rasteve. PKDNJ e ka përfunduar mandatin e tij dhe e ka nxjerrë Raportin Final të tij më 30 qershor 2016.

### **Rastet e personave të vrarë dhe të zhdukur**

Shumë prej këtyre rasteve kishin të benën me shkeljet e pohuara të drejtave të njeriut nga ana e UNMIK-ut ku përfshihen pohimet për hetime joefektive të rrëmbimeve, zhdukjeve dhe vrasjeve, si dhe trajtimit çnjerëzor të pakicave etnike dhe kundërshtarëve politikë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në rastet e personave të vrarë dhe të zhdukur, d.m.th. rastet e “zhdukjeve me forcë”.

PKDNJ ka konstatuar se UNMIK-u i kishte kryer 233 shkelje të drejtave të njeriut nga neni 2, “e drejta për jetën” i Konventës, mes tjerash, me anë të moskryerjes së hetimeve adekuate dhe efektive lidhur me zhdukjen apo rrëmbimin dhe/ose vrasjen e të afërmeve të ankuesve.

PKDNJ ka vërejtur se vetëm 5 nga këto raste kishin të bënin me shqiptarë të Kosovës dhe se viktimat në 2 nga këto 5 raste kishin punuar ose kishin lidhje me policinë apo forcat e sigurisë të Serbisë. Për këto raste si të dyshuar ishin përmendur pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. PKDNJ në këto raste kishte rekomanduar që UNMIK-u duhej ta pranonte publikisht përgjegjësinë për mos-hetimin adekuat të zhdukjeve dhe vrasjeve të viktimave dhe t'u kërkonte falje publike ankuesve dhe familjeve të tyre. Për më shumë, PKDNJ ka rekomanduar që UNMIK-u ta paguajë kompensimin për dëmet jo-materiale të pësuar nga ankuesit për shkak të mos bërjes së hetimeve adekuate dhe efektive.

### **Lëndët pronësore**

Në përgjithësi, në lidhje me çështjet pronësore, zyrtarisht duhet përmendur të ashtuquajturat “14,000 lëndë pronësore”, shumë nga të cilat janë shqyrtuar nga PKDNJ-ja. Këto lëndë kanë të bëjnë me serbët e Kosovës që janë larguar nga shtëpitë e tyre dhe kanë ikur në Serbi, kryesisht kah fundi i konfliktit të armatosur në pjesën e fundit të vitit 1999. Shumë prej këtyre pronave më vonë

janë uzurpuar, shpronësuar, dëmtuar ose shkatërruar. Në vitin 2004, në gjykatat kosovare janë parashtruar rreth 17,000 kërkesa për kompensim. Shumica dërmuese e këtyre rasteve janë parashtruar nga serbët etnikë, në mënyrë që ta respektonin afatin e parashkrimit prej pesë vjet për parashtrimin e këtyre kërkesave civile për kompensim. Vazhdimi i uzurpimit të kundërligjshëm të këtyre pronave për të cilat kishte vendosur Agjencia Kosovare e Pronës, thuhet të ketë qenë një prej shqetësimeve kryesore të PKDNJ-së.

Në bazë të disa informatave për historikun e kësaj çështjeje, Drejtori i atëhershëm i Departamentit të Drejtësisë (D/DiD) i UNMIK-ut, më 26 gusht 2004 u kishte dërguar letër të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe të qarkut, si dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Ai theksonte se “mbi 14,000” kërkesa ishin parashtruar nëpër gjykata dhe ai i përmendte “problemet të cilat do t’i shkaktonte për gjykatat ky fluks i madh i kërkesave”. D/DiD kërkonte që “asnjë [prej këtyre] rasteve të mos caktohej deri atëherë kur të vendosim bashkërisht për mënyrën më të mirë të trajtimit të këtyre lëndëve”. Më 15 nëntor 2005, D/DiD kishte kërkuar nga gjykatat që t’i trajtojnë kërkesat për dëme të cilat ishin shkaktuar nga persona fizikë të identifikuar dhe për dëmet të cilat ishin shkaktuar pas muajit tetor 2000, duke vlerësuar se nuk ekzistonin më “pengesat për trajtimin efikas të këtyre lëndëve”.

### **Dorëzimi i mandatit ekzekutiv**

Mandati ekzekutiv i UNMIK-ut ka përfunduar më 9 dhjetor 2008 në të cilën kohë misionit EULEX-i Kosovë i është ngarkuar përgjegjësia për sundimin e ligjit në Kosovë.

UNMIK-u dhe EULEX-i njëkohësisht e kanë nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit për modalitetet dhe të drejtat dhe obligimet përkatëse që burojnë nga transferimi i rasteve të “zhdukjeve me forcë” dhe dosjeve përkatëse prej UNMIK-ut te EULEX-i lidhur me hetimet në proces dhe ndjekjet penale që ishin bërë deri në atë moment nga prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut.

PSSP-ja i UNMIK-ut e kishte këshilluar PKDNJ-në në atë kohë që zgjidhja më e mirë për rastet e “zhdukjeve me forcë” ishte që EULEX-i dhe autoritetet tjera kompetente (kosovare) të vazhdonin hetimet dhe ndjekjet penale.

Po ashtu, PKDNJ kishte rekomanduar që UNMIK-u të merrte garanci nga autoritetet kosovare që rastet pronësore të parashtruara nga ankuesit të trajtoheshin nga gjykatat e Kosovës. Rrjedhimisht, UNMIK-u i kishte dërguar EULEX-it një letër formale me kërkesë që t’i monitoronte këto raste në gjykatat kosovare.

PKDNJ kishte rekomanduar, gjithashtu, që UNMIK-u t’u jepte ankuesve kompensim adekuat për dëmet jo-materiale të pësuar nga stërzgjatja e pezullimit të procedurave në rastet pronësore të cilat ishin përfunduar.

### **Kritikat për UNMIK-un**

Kryesuesi i PKDNJ-së në Raportin Final të tij ishte jashtëzakonisht kritik ndaj UNMIK-ut. Në veçanti, ai ishte kritik ndaj faktit se UNMIK-u nuk i kishte zbatuar rekomandimet e PKDNJ-së. Rrjedhimisht, ai ka përfunduar se, përkundër resurseve të mëdha të investuara në përpunimin e informatave, nxjerrjen e vendimeve për pranueshmërinë si dhe të mendimeve dhe rekomandimeve, nuk ishte arritur shumë për shkak të mos-përmbushjes së këtyre rekomandimeve nga ana e UNMIK-ut.

Për shkak të hezitimit të UNMIK-ut që ta bëjë këtë, Kryesuesi i PKDNJ-së ka theksuar se puna e tij “nuk kishte arritur të siguronte rivendosje për ankuesit.” “Duke qenë kështu, ata janë viktimizuar

dy herë nga UNMIK-u, fillimisht nga shkelja fillestare e të drejtave të njeriut e kryer nga UNMIK-u ndaj tyre dhe së dyti, duke i pasur shpresa dhe besim në këtë proces”.

Ai, gjithashtu, ishte kritik ndaj çfarëdo sugjerimi për dorëzimin e juridiksionit mbi rastet e “zhdukjeve me forcë” tek autoritetet kosovare, aq më pak për shkak se pothuaj të gjitha këto raste kishin të bënin me viktimat që ishin serbë të Kosovës. Këta ankues serbë ishin të brengosur me arsye lidhur me sigurinë e tyre kur i kanë parashtruar ankesat e tyre në UNMIK dhe pastaj në PKDNJ, prandaj shumë prej tyre kanë kërkuar që të mbeteshin anonimë.

### **Trashëgimia dhe historiku i punës**

Pavarësisht shumë sfidave dhe pengesave me të cilat është përballur PKDNJ, ai ka bërë përparime të mëdha sa i përket trashëgimisë dhe punës së tij. Konkretisht, Paneli i ka kontribuar mendimeve ndërkombëtare lidhur me çështjet e shumta në kontekstin e standardeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht atyre që kanë të bëjnë me llogaridhënien për të drejtat e njeriut të organizatave ndërkombëtare në rolin e autoriteteve ekzekutive.

Përvojat dhe mësimet të cilat i ka marrë PKDNJ-ja gjatë punës së tij si një organ kuazi-gjyqësor për të drejtat e njeriut në kohën kur UNMIK-u, një mision i OKB-së, e kishte marrë rolin e një “shteti surrogat” ishte një aspekt tjetër i rëndësishëm i trashëgimisë ligjore të tij. Kjo përvojë ka paraqitur shtysë të fuqishme për diskutimet e mëtejme rreth asaj se çfarë do të ishte model optimal i organit për shqyrtimin e të drejtave të njeriut për të vepruar brenda një konteksti të veçantë të një misioni ndërkombëtar që e administron një territor të përcaktuar. Në këtë drejtim, Raporti Final ka paraqitur sugjerime lidhur me strukturën surrogate dhe mënyrën e veprimit që mund ta ketë një organ i tillë, në rast se do të ketë nevojë për një mision tjetër si ky në të ardhmen.

Kryesuesi i PKDNJ-së në komentet e tij në Raportin Final ka përfunduar si në vijim; “Na mbetet të shpresojmë se të paktën disa nga këto raste (zhdukjet me forcë) do ta gjejnë rrugën deri te regjistri i tribunalit special të krijuar nga bashkësia ndërkombëtare dhe autoritetet kosovare – Institucioni i Gjyqësor i Specializuar i Zhvendosur i Kosovës (IGJSK) – juridiksioni i të cilit i përfshin ‘krimet e rënda që supozohet se janë kryer në vitet 1999-2000 nga pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kundër pakicave kombëtare dhe kundërshtarëve politikë”.

## **9. Përfundimet dhe rekomandimet**

### **Pranimi i shkeljeve të drejtave të njeriut nga EULEX-i**

Në një numër të rasteve kur shkeljet e të drejtave të njeriut i ishin ngarkuar këtij Misioni, Paneli i ka rekomanduar SHM-së që ta bëjë publikisht pranimin e këtij fakti. Pranimi i përgjegjësisë në fushën e të drejtave të njeriut cilësohet si një prej formave të zgjidhjes efektive të shkeljes. Deri më tani, SHM në mënyrë të vazhdueshme nuk ka pranuar që ta bëjë këtë.

Baza e këtij hezitimi duket se është brenga e ndërlidhur me mundësinë e përgjegjësisë dhe proceseve të mëtejme gjyqësore. Paneli nuk është i bindur nga ky argument. Së pari, pasi që vet Paneli ta ketë konstatuar ndonjë shkelje, ndonjë organ i këtij Misioni e ka bërë këtë përcaktim për të gjitha qëllimet. Ndonëse nuk ka pasur ndonjë të dhënë për padi të inicuar si rezultat i konstatimeve dhe vendimeve të panelit.



Së dyti, ky pranim mund të formulohet lehtë në atë mënyrë që nuk e mbart pranimin e përgjegjësisë civile përtej asaj që tashmë ka mundur ta shkaktojë Misioni si rezultat i funksionit të tij. Së treti, në mungesë të mundësisë që, në bazë të regjimit që e rregullon atë, Paneli të rekomandojë kompensime financiare, pranimi i përgjegjësisë do të siguronte një mjet të rëndësishëm (megjithëse shpesh të pamjaftueshëm) për zgjidhje efektive të gabimit. Në bazë të kësaj, Paneli i bën thirrje SHM-së, në konsultim me autoritetet përkatëse, që t'i shqyrtojë më tej implikimet e këtij pranimi me qëllim që SHM-së t'i mundësohet shqyrtimi i ndryshimit të praktikës në të ardhmen.

### **Rastet e personave të vrarë dhe të zhdukur**

Është theksuar se UNMIK-u dhe EULEX-i e kanë nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit më 26 nëntor 2008 për modalitetet dhe të drejtat dhe obligimet përkatëse që burojnë nga transferimi i rasteve të personave të vrarë dhe të zhdukur d.m.th. "zhdukjeve me forcë" dhe dosjeve përkatëse prej UNMIK-ut të EULEX-i lidhur me hetimet në proces, ndjekjet penale dhe veprimeve tjera që ishin ndërmarrë për këto raste deri në atë moment nga prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut.

Më tej është konstatuar se PKDNJ i UNMIK-ut, në Raportin Final të tij më 30 qershor 2016, ka rekomanduar që EULEX-i Kosovë duhet t'i vazhdojë hetimet për këto raste të personave të vrarë dhe të zhdukur në mënyrë që t'i përmbushte kërkesat e nenit 2 të Konventës. Është e domosdoshme që të ndriçohen rrethanat e "zhdukjes me forcë" të këtyre pjesëtarëve të pakicave kombëtare, duke i përfshirë edhe kundërshtarët politikë dhe që autorët e supozuar nga radhët e UÇK-së dhe grupeve tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës të sillen para drejtësisë.

Po ashtu, vlen të përmendet se Kryesuesi i PKDNJ ka theksuar se bartja e juridiksionit për këto raste tek autoritetet kosovare nuk ishte zgjidhje e zbatueshme meqë, mes tjerash, gati shumica e këtyre rasteve kishin të bënin me serbë të Kosovës si viktime. Ishte e kuptueshme që këta ankues ishin të brengosur për sigurinë e tyre në kohën kur i kanë parashtruar këto ankesa në UNMIK dhe më vonë në PKDNJ dhe në fakt në shumicën e rasteve kishin kërkuar të mbeteshin anonimë.

Në frymën e vendimeve dhe konstatimeve të fundit të Panelit në lidhje me rastet e "zhdukjeve me forcë" gjatë periudhës raportuese, është rekomanduar që EULEX-i Kosovë ta shqyrtojë mundësinë e sigurimit të burimeve të domosdoshme njerëzore dhe materiale në mënyrë që të kryejë hetime të thukëta për rastet të cilat janë transferuar nga UNMIK-u në EULEX-i Kosovë në nëntor 2008.

Paneli beson se zgjidhja efektive e këtyre rasteve dhe mbështetja e të drejtave të afërmve të viktimave, kërkon një qasje të përgjithshme e cila do të përfshinte të gjitha palët e përfshira – SHM i EULEX-i Kosovë, PSBE në Kosovë, autoritetet kosovare dhe të gjithë të tjerët që janë aktivë në Kosovë në lidhje me zgjidhjen e këtyre rasteve, në veçanti të rasteve të "zhdukjes me forcë". Bashkimi i resurseve nga palët në fjalë dhe miratimi i një strategjie koherente ndërmjet këtyre aktorëve të ndryshëm është shumë me rëndësi, dhe në fakt e domosdoshme për t'i garantuar në mënyrë efektive të drejtat e të afërmve të personave të vrarë dhe të zhdukur.

### **Prioritetizimi i rasteve**

Një numër i ankesave të paraqitura në Panel kishin të bënin me pohimet për hetimet joadekuate, jo të plota apo jo-ekzistuese të pretendimeve serioze për shkeljet e të drejtave nga ana e këtij Misioni. Paneli ka përcaktuar se një numër i këtyre ankesave kishin bazë dhe se shkeljet në këtë kontekst kishin ndodhur.

Si pjesë e vlerësimit të tij të këtyre rasteve, Paneli menjëherë vërejti një numër të problemeve sistematike lidhur me trajtimin e këtyre rasteve, duke e përfshirë bashkërendimin joadekuat me Misionin dhe regjistrimin joadekuat të rasteve, etj.

Një prej këtyre çështjeve sistematike duket sa ka të bëjë me mos-prioritetizimin e rasteve nga ana e prokurorëve të EULEX-it që në mënyrë të qartë dhe të dukshme ngrijnë çështje serioze të drejtave të njeriut. Në veçanti këto përfshijnë shumë rasteve të pa-hetuara apo të hetuara në mënyrë joadekuate të zhdukjeve me forcë që ndërlidhen me konfliktin në Kosovë. Po ashtu, ato kanë të bëjnë me një numër të rasteve të rënda që kanë të bëjnë me të drejtat themelore të pakicave, duke e përfshirë "*rastin e romëve*", i cili është parashtruar në PKDNJ dhe në PSHDNJ.

Prandaj duket se është shumë me rëndësi që, gjatë ushtrimit të detyrave të mbetura hetimore dhe prokuroriale të tij, ky Mision duhet të përpiqet që t'u jep një shkallë të caktuar të prioritetit dhe urgjencës hetimit efektiv të këtyre rasteve që kanë të bëjnë me shkelje të rëndë dhe sistematike të drejtave të njeriut.

### **Vazhdimi i përforsimit të sundimit të ligjit në Kosovë**

Është me rëndësi që vendet e BE-së, në veçanti përmes EULEX-it Kosovë, t'i përkrahin angazhimet në Kosovë për përforsimin e sundimit të ligjit. Garantimi i pavarësisë, paanësisë dhe efektivitetit të gjyqësorit si dhe sigurimi i hetimit efektiv të shkeljeve të drejtave të njeriut të cilat kanë ndodhur ë Kosovë duhet të mbesin prioritet i këtij Misioni dhe vetë BE-së. Veçanërisht me rëndësi në këtë kontekst është përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të pakicave me qëllim që të parandalohet çfarëdo lloji i diskriminimit, veçmas ai në bazë të përkatësisë etnike apo fetare.

### **Programi i reparacionit**

Pagesa e kompensimit për ankuesit dhe anëtarëve përkatës të familjeve të tyre është një temë konstante në domenin publik në rast të kryerjes së shkeljeve të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë. Fakti që Ankesa arsyetohet me konstatimin e shkeljes së të drejtave të njeriut është ngushëllim i vogël në kontekstin e të drejtave themelore për të cilat bëhet fjalë në këto raste.

Prandaj rekomandohet që EULEX-i ta shqyrtojë me seriozitet krijimin e një programi të plotë dhe gjithëpërfshirës të reparacionit, i cili do të përfshinte kthimin e pronës, kompensimin, rehabilitimin, satisfaksionin dhe garancitë për mos-përsëritje, për viktimat, ankuesit dhe pjesëtarët e familjeve dhe palët tjera përkatëse.

### **Kthimi i pronës**

Në lidhje me rastet pronësore, është theksuar se PKDNJ kishte rekomanduar që UNMIK-u duhej të angazhohej që të merrte garanci nga autoritetet kosovare që rastet e paraqitura nga ankuesit e tyre do të trajtohen. UNMIK-u e ka pranuar rekomandimin nga PKDNJ dhe i ka dërguar një letër EULEX-it Kosovë me kërkesë që ai ta monitorojë këtë proces.

PKDNJ tashmë ka konstatuar se kishte shkelje të nenit 6 (1) të Konventës në shumicën e ankesave pronësore të cilat ishin trajtuar nga gjykatat kosovare dhe ka kërkuar nga autoritetet kompetente që të ndërmarrin të gjithë hapat e mundshëm për të siguruar që këto raste të shqyrtohen pa vonesa të mëtejshme.

Në këtë drejtim, Komisioni Evropian në Dokumentin e tij të punës për personelin në Raportin për Kosovën 2016, (9 nëntor 2016) ka theksuar se: “Mbetet shqetësues progresi i kufizuar në garantimin efektiv të drejtave pronësore dhe kthimi dhe integrimi i personave të zhvendosur”.

Siç është thënë më sipër në këtë raport, pamundësia e Panelit për të rekomanduar kompensimin, reparacionin si dhe kthimin e pronës ankuesve është burim konstant i kritikave për këtë Panel. Mund të thuhet se një program i rregullt për kthimin e pronës është tregues i efektivitetit të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike dhe në rast se kthimi i pronës nuk është i mundur në vend të kësaj do duhej të paguhet një kompensim adekuat.

### **Jurisprudenca**

Jurisprudenca e Panelit ka qenë objekt interesimi në rritje në kuadër të subjekteve të ndryshme të cilat merren me mbrojtjen ndërkombëtare të drejtave të njeriut. Kjo gjë dëshmohet nga hulumtimet akademike të studentëve si dhe nga materialet tjera të botuara. Mund të thuhet se përvoja e këtij Paneli tashmë konsiderohet se është një element i rëndësishëm në debatet që po zhvillohen për llogaridhënien e organizatave ndërkombëtare për shkeljet e supozuara të drejtave të njeriut në rolet ekzekutive të tyre.

## SHTOJCA 1 Tabela e personelit

<b>Paneli</b>	
<b>Magda Mierzewska</b>	Kryesuese e Panelit
<b>Guénaël Mettraux</b>	Anëtar i Panelit
<b>Elka Ermenkova</b>	Anëtare e Panelit, gjyqtare e EULEX-it
<b>Anna Bednarek</b>	Anëtare zëvendësuese e Panelit, gjyqtare e EULEX-it

<b>Sekretariati</b>	
<b>John J. Ryan</b>	Zyrtar i lartë ligjor
<b>Noora Aarnio</b>	Zyrtare ligjor
<b>Katica Kovacevic</b>	Përkthyes (serbisht-anglisht)
<b>Kushtrim Xhaferi</b>	Përkthyes (shqip-anglisht)

## SHTOJCA 2 Statistikat 2010 - 2016

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Gjithsej
Lëndët e regjistruara - Gjithsej	16	28	23	27	42	16	36	188
Lëndët e përfunduara - Gjithsej	6	30	10	20	28	27	19	140
Të pranueshme			2		1	8	0	11
Të papranueshme	6	22	10	13	22	12	9	94
Shkelje	0	2	0	7	2	4	9	24
Nuk ka shkelje	0	5	0	0	1	10	0	16
Të hequra në lista	0	1	0	0	3	1	1	6

	Më 31 dhjetor 2016
Lëndët e papërfunduara	48
Të komunikuar te SHM	15

**SHTOJCA 3 Vendimet e PShDNj-së 2010-2016**

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2010-01	Djeljalj Kazagic	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, çështje pronësore	Shkelje
2010-02	Sadik Thaqi	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-03	Osman Mehmetaj	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-04	Feti Demolli	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-05	Mursel Hasani	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-06	Latif Fanaj	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-07	Blerim Rudi	Dyshohet në mos zbatim të urdhrit të lëshuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për rikthim në punë të ankuesit nga ana e Njësisë së Inteligjencës Financiare	Shkelje
2010-08	Delimir Krstic	Dyshohet në mos veprim nga policia dhe prokuroria e EULEX-it, çështje pronësore	E papranueshme
2010-09	Burim Ramadani	Dyshohet në mos-funksionim të sistemit gjyqësor, rasti Kiçina	E papranueshme
2010-10	Horst Proetel	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë në EULEX	E papranueshme
2010-11	Laura Rudi	Ankesë private financiare ndaj një punëtori të EULEX-it	E papranueshme
2010-12	Hunaida Pasuli	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë pune në EULEX	E papranueshme
2010-13	Një punëtor i EULEX-it	Kontest i brendshëm në EULEX lidhur me vlerësimin e punës dhe marrëdhëniet personale me mbikëqyrësin	E papranueshme
2010-14	Lulzim Gashi	Kandidim jo i suksesshme në një pozitë pune në EULEX	E papranueshme
2010-15	Faton Sefa	Mos rikthimi në vendin e mëparshëm të punës (sektor privat), dyshohet në mos zbatim të vendimit të gjykatës	E papranueshme
2010-16	Cyma Agovic	Transferuar nga EULEX-i – Mos shqyrtim i drejtë i lëndës së ankueses nga ana e gjykatësve të EULEX-it	E papranueshme

<b>2011-01</b>	Familja e Dedë Gecaj	Kërkesë për hetim të vendimit të gjykatave të EULEX-it në Kosovë për ekstradim në rastin e të ndjerit Dedë Gecaj	E papranueshme
<b>2011-02</b>	Chamalagai Krishna Bahadur	Dyshohet në mos veprim	E papranueshme
<b>2011-03</b>	Afrim Mustafa	Kontest në lidhje me një radio stacion privat dhe konfiskimi i pajisjeve të radio stacionit	E papranueshme
<b>2011-04</b>	Besim Berisha	Ankesë rreth kushteve të jetës në burgun e Dubravës	E hequr nga lista e ankesave
<b>2011-05</b>	SH.P.K "Syri"	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, SCSC	E papranueshme
<b>2011-06</b>	Milazim Blakqori	Dyshohet në moszbatimin e një vendimi, mosveprim nga ana e EULEX-it	E papranueshme
<b>2011-07</b>	Lënda W	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2011-08</b>	Anton Rruka	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, SCSC	E papranueshme
<b>2011-09</b>	Mirkovic Bojan	Dyshohet në largim nga puna në mënyrë të paligjshme nga EULEX-i	E papranueshme
<b>2011-10</b>	Dejan Jovanovic	Dyshohet në vonesë të panevojshme gjatë procedurave në SCSC	E papranueshme
<b>2011-11</b>	Srecko Martinovic	Dyshohet në përdorim të tepruar të forcës, trajtim dhe mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2011-12</b>	Novica Trajkovic	Dyshohen në përdorim të tepruar të forcës	E papranueshme
<b>2011-13</b>	S.M.	Dyshohet në përdorim të tepruar të forcës, mohim të së drejtës për gjykim të drejtë dhe mos respektim të jetës private	E papranueshme
<b>2011-14</b>	Lindita Shabani	Dyshohet në mohim të së drejtës për jetë private dhe familjare	E papranueshme
<b>2011-15</b>	Samedin Smajli	Dyshohet në mohim të gjykimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
<b>2011-16</b>	Avdyl Smajli	Dyshohet në mohim të gjykimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
<b>2011-17</b>	Faik Azemi	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2011-18</b>	Mykereme Hoxha	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it	E papranueshme
<b>2011-19</b>	Sefer Sharku	Dyshohet në mos respektim të një vendimi detyrues gjyqësor	E papranueshme

<b>2011-21</b>	Ventor Maznikolli	Dyshohet në vonesë të panevojshme nga gjykatësit e EULEX-it rreth caktimit të një seance në Gjykatën Supreme	E papranueshme
<b>2011-22</b>	Hysni Gashi	Dyshohet në mohim të një gjykimi të drejtë dhe dyshohet në paaftësi të gjykatësve të EULEX-it	E papranueshme
<b>2011-23</b>	Hashim Rexhepi	Dyshohet në shkelje të së drejtës për liri dhe të së drejtës për gjykim të drejtë.	E papranueshme
<b>2011-24</b>	Predrag Lazic	Dyshohet në mos caktimin e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm	E papranueshme
<b>2011-25</b>	Shaip Gashi	Dyshohet në privim nga pensioni gjerman për persona me paaftësi	E papranueshme
<b>2011-26</b>	Njazi Asllani	Dyshohet në mos zbatim të një vendimi, mos veprim nga EULEX-i	E papranueshme
<b>2011-28</b>	Lënda Y	Dyshohet në shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare.	E papranueshme
<b>2012-01</b>	Qamil Hamiti	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2012-02</b>	Arben Zeka	Dyshohet në mos gjykim të një lënde pronësore	E papranueshme
<b>2012-03</b>	Rexhep Dobruna	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2012-04</b>	Izet Maxhera	Kontest pronësor me EULEX-in në Mitrovicë	E papranueshme
<b>2012-05</b>	Fatmir Pajaziti	Dyshohet në shkelje të së drejtës për liri dhe gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2012-06</b>	Lënda Z	Dyshohet në shkelje të nenit 10 dhe 11 të DUDNj-së, nenet 5 dhe 6 të KEDNj-së, nenit 9 të KDDCP-së dhe nenit 6 të KKT-së	E papranueshme
<b>2012-07</b>	Lënda I	Dyshohet në mosveprim nga ana e prokurorit të EULEX-it dhe policisë së EULEX-it	E papranueshme
<b>2012-08</b>	Lënda U	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2012-09</b>	Lënda A	Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-10</b>	Lënda B	Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-11</b>	Lënda C	Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-12</b>	Lënda D	Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-13</b>	Bejtush Gashi	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme



<b>2012-15</b>	Shefqet Emerllahu	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, mos hetim	E papranueshme
<b>2012-16</b>	Kristian Kahrs	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, mosveprim	E papranueshme
<b>2012-17</b>	Lënda E	Dyshohet në shkelje të nenet 5 dhe 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2012-18</b>	Hamdi Sogojeva	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2012-19</b>	Lënda H	Dyshohet në konfiskim të pronës	Shkelje
<b>2012-20</b>	Lënda G	Dyshohet në shkelje të neneve 3, 10, 11 të KEDNj-së dhe nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-21</b>	Mirko Krlic	Dyshohet në shkelje të nenit 9 të KEDNj-së dhe nenit 2 të Protokollit 4 të KEDNj-së	Nuk ka shkelje
<b>2012-23</b>	Predrag Blagic	Dyshohet në shkelje të nenit 5 të KEDNj-së dhe nenit 2 të protokollit 4 të KEDNj-së	E hequr nga lista e ankesave
<b>2013-01</b>	Lënda I	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-02</b>	Arsim Krasniqi	Dyshohet në shkelje të nenit 3 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-03</b>	Goran Becic	Dyshohet në shkelje të nenit 5 dhe 14 të KEDNj-së dhe nenit 2 të protokollit 1 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2013-04</b>	J	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-15</b>	Gani Zeka	Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-16</b>	Almir Susaj	Dyshohet në shkelje të nenit 3 dhe 8 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-17</b>	Ramadan Rahmani	Dyshohet në shkelje të nenit 1 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-18</b>	Jovanka, Dragan, Milan Vukovic	Dyshohet në shkelje të nenit 1 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-19</b>	U	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-20</b>	Shaip Gashi	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-22</b>	Gani Gashi	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-23</b>	V	Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-24</b>	Emin Maxhuni	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-25</b>	Milorad Rajovic	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme

<b>2013-26</b>	Selami Taraku	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-27</b>	Shaban Kadriu	Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-01</b>	Nexhat Qubreli	Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-03</b>	Lënda A.Z.	Dyshohet në shkelje të nenit 3, 8 dhe 13 i KEDNj-së	E hequr nga lista e ankesave
<b>2014-04</b>	Tomë Krasniqi	Dyshohet në shkelje të nenit 1, 3, 6, 14 dhe 17 të KEDNj-së, nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-06</b>	Lënda B.Y.	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-07</b>	Fitore Rastelica	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-08</b>	C.X.	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-09</b>	Rifat Kadribasic	Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-19</b>	Fahri Rexhepi	Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-20</b>	Mensur Fezaj	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-21</b>	Shefki Hyseni	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 KEDNj-së	E hequr nga lista e ankesave
<b>2014-22</b>	Ismajl Krapu	Dyshohet në shkelje të nenit 5 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-23</b>	Shaip Selmani	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-25</b>	Nuha Beka	Kontest punësimi	E papranueshme
<b>2014-28</b>	Selatin Fazliu	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-03</b>	Lënda A.Z.	Dyshohet në shkeljen e neneve 3, 8 dhe 13 të KEDNj-së	E hequr nga lista
<b>2014-04</b>	Tomë Krasniqi	Dyshohet në shkeljen e nenit 1, 3, 6, 14 dhe 17 KEDNj-së, neni 1 i protokollit nr. 1 KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-05</b>	Mazlam Ibrahim	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-06</b>	Lënda B.Y.	Dyshohet në shkeljen e Nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-07</b>	Fitore Rastelica	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-08</b>	C.X.	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme

<b>2014-09</b>	Rifat Kadribasic	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-18</b>	Fitim Maksutaj	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2014-19</b>	Fahri Rexhepi	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-20</b>	Mensur Fezaj	Dyshohet në shkeljen e nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-21</b>	Shefki Hyseni	Dyshohet në shkeljen e nenit 5 të KEDNj-së	E hequr nga lista
<b>2014-22</b>	Ismajl Krapit	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-23</b>	Shaip Selmani	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-24</b>	Lënda J.Q.	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-25</b>	Nuha Beka	Kontest në punë	E papranueshme
<b>2014-28</b>	Selatin Fazliu	Dyshohet në shkeljen e nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-26</b>	Ajet Kaçiu	Dyshohet në shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-27</b>	Qerim Begolli	Dyshohet në shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-29</b>	Shemsi Musa	Dyshohet në shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-30</b>	Abdilj Sabani	Dyshohet në shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-31</b>	Lënda K.P.	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-32</b>	L.O.	Dyshohet në shkeljen e nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2014-33</b>	Arben Krasniqi	Dyshohet në shkeljen e nenit 5 dhe 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-38</b>	Slavica Mikic	Dyshohet në shkeljen e nenit 13 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-40</b>	Avni Hajdari	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E hequr nga lista
<b>2014-41</b>	Liridona Mustafa Sadiku	Dyshohet në shkeljen e nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-42</b>	Bujar Zherka	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2015-03</b>	Dekart Shkololli	Dyshohet në shkeljen e nenit 8 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2015-07</b>	Dobriboje Radovanovic	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2015-08</b>	Afrim Berisha	Dyshohet në shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2015-09</b>	Driton Hajdari	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme

<b>2015-10</b>	Shaban Syla	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2015-13</b>	Rasti W.D.	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 dhe 8 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2016-03</b>	Afrim Islami	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme

#### SHTOJCA 4 Orari i fushatës informuese dhe aktivitetet e tjera në vitin 2016

	Data	Vendi	Ngjarja	Paneli	Sekretariati	Organizata
1.	03/02/16	Zyra për Kosovë dhe Metohi, Lagja e Boshnjakëve, Mitrovicë e veriut	Takim me znj. Zlata Radovanovic, koordinatorë e zyrës për Kosovë dhe Metohi dhe Bratislava Radovanovic, zyrtare e zyrës për Kosovë dhe Metohi		John J Ryan Katica Kovacevic	Zyra për Kosovë dhe Metohi
2.	01/03/16	Zyra e PShDNj-së	Takim me z. John Rouse, Shef i Kabinetit, EULEX-i Kosovë	Magda Mierzewska, Guenael Mettraux, Katja Dominik Elka Filcheva- Ermenkova	Paul Landers Joanna Marszalik	
3.	01/03/16	Zyra e PShDNj-së	Takim me Znj. Heidi Lempio zyrtare ligjore, Linde Bryk zyrtare ligjore dhe praktikantët e ZLÇGJ, Znj. Laura Fournier dhe Alessio Gracis	Magda Mierzewska, Guenael Mettraux, Katja Dominik Elka Filcheva- Ermenkova	Paul Landers Joanna Marszalik	
4.	14/04/16	Mitrovicë	Takim me z. Kadri Osaj, Avokat		Paul Landers Kushtrim Xhaferi	
5.	16/05/16	Selia e UNMIK-ut, Prishtinë	Takim me Znj. Miriam Ghalmi, këshilltare e lartë për të drejta të		John J Ryan	

			njeriut, Shefe e Seksionit për të Drejta të Njeriut, Z/PSSP, UNMIK			
6.	24/05/16	Qendra Kosovare për Drejtësi Prishtinë	Takim me z Bekim Blakaj, Drejtor Ekzekutiv, Qendra Kosovare për Drejtësi		John J Ryan Kushtrim Xhaferi	
7.	01/06/16	Manastiri i Deçanit, Pejë	Takim me Atë Sava Janjic, Abat i Manastirit të Deçanit		John J Ryan Katica Kovacevic	
8.	02/06/16	Zyra për Kosovë dhe Metohi, Lagja e Boshnjakëve, Mitrovicë e veriut	Takim me znj. Zlata Radovanovic, koordinatorë e zyrës për Kosovë dhe Metohi dhe Bratislava Radovanovic, zyrtare për çështje politike e zyrës për Kosovë dhe Metohi		John J Ryan Katica Kovacevic	
9.	06/06/16	Shoqata për personat e zhdukur dhe të rrëmbyer në Graçanicë	Takim me Znj. Silvana Marinkovic, Kryetare e Shoqatës për personat e zhdukur dhe të rrëmbyer në Graçanicë		Paul Landers Katica Kovacevic	
10.	21/06/16	Shoqata për personat e zhdukur dhe të rrëmbyer në Mitrovicë n veriore	Takim me z. Milorad Trifunovic, Kryetar i Shoqatës për personat e zhdukur dhe të rrëmbyer në Mitrovicën veriore		Paul Landers Katica Kovacevic	
11.	23/06/16	Qendra për paqe dhe tolerancë, rr. Milosa Obilic, pn 10500	Takim me Nenad Maksimovic, Drejtor Ekzekutiv, Qendra për paqe dhe tolerancë & Seminar – Prezantimi i		John J Ryan Katica Kovacevic	

		Graçanicë	hulumtimit për ndërmarrësinë sociale			
12.	04/07/16	Shoqata për personat e zhdukur dhe të rrëmbyer në Hoçë të Madhe	Takim me Negovan Mavric, Rahovec, Hoçë e Madhe, Kryetar i Kryetar i Shoqatës për personat e zhdukur dhe të rrëmbyer në Hoçë të Madhe		Paul Landers Katica Kovacevic	
13.	13/07/16	Shoqata "Thirrjet e nënave" Gjakovë	Takim me Nestrete Kumnova, përfaqësuese e Shoqatës "Thirrjet e nënave" Gjakovë		Paul Landers Shpresa Gosalci Kushtrim Xhaferi	
14.	14/07/16	Shoqata për personat e zhdukur dhe të rrëmbyer në Shtërpçë	Takim me Znj. Dragana Milatovic, Brezovicë, Shtërpçë, Kryetare e Kryetar i Shoqatës për personat e zhdukur dhe të rrëmbyer në Shtërpçë		Paul Landers Katica Kovacevic	
15.	15/07/16	Shoqata "26 mars 1999" në Krushë e vogël	Takim me Agron Limani, Kryetar i Shoqatës "26 mars 1999" në Krushë të Vogël		Paul Landers Shpresa Gosalci Kushtrim Xhaferi	
16.	18/07/16	Shoqata "27 prill 1999" në Gjakovë	Takim me Haki Sadriu & Engjëll Berisha, Kryetar dhe nënkryetar të Shoqatës "27 prill 1999" (fshati Mejë) Gjakovë		Paul Landers Shpresa Gosalci Kushtrim Xhaferi	
17.	17/10/16	Selia e PSBE, rr. Kosova Nr. 1, Prishtinë	Takim – Përfaqësuesja Speciale e bashkimit Evropian Nataliya Apostolova dhe Shaban Murturi	Guenael Mettraux, Elka Ermenkova	John J Ryan	Selia e PSBE, Përfaqësuesja Speciale e bashkimit Evropian
18.	17/10/16	Zyra e PShDNj-	Takim me Znj. Alexandra	Guenael Mettraux,	John J Ryan	

		së	Papadopoulou, Shefe e Misionit EULEX, Elaine A Paplos, Marianne Fennema, dhe Heidi Lempio	Elka Ermenkova		
19.	28/10/16	Zyra e EEAS, Bruksel	Takim me z. Alexis Hupin, zyrtar për Kosovë, CPCC, Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm në EEAS	Magda Mierzevska	John J Ryan	
20.	28/10/16	Zyra e EEAS, Bruksel	Takim me Znj. Jana Kaliminova, Kryesuese e CivCom dhe Mr Alexis Hupin, zyrtar për Kosovë, CPCC, Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm në EEAS	Magda Mierzevska	John J Ryan	
21.	28/10/16	Zyrat Justus Lipsius, Bruksel	Takim me përfaqësuesit e vendeve anëtare në Grupit Punues në CivCom	Magda Mierzevska	John J Ryan	
22.	28/10/16	Zyra e EEAS, Bruksel	Takim me z. Bert Vermessen, Zëvendës-komandant për Operacione Civile & Shef i Kabinetit, CPCC dhe z. Alexis Hupin, zyrtar për Kosovë	Magda Mierzevska	John J Ryan	
23.	06/12/16	Zyra për Kosovë dhe Metohi, Lagja e Boshnjakëve, Mitrovicë e veriut	Takim me znj. Zlata Radovanovic, koordinatore e zyrës për Kosovë dhe Metohi dhe Bratislava Radovanovic, zyrtare për çështje politike e zyrës për Kosovë dhe Metohi		John J Ryan, Noora Aarnio dhe Katica Kovacevic	Zyra për Kosovë dhe Metohi
24.	01/12/16	Zyra e PShDNj-së	Takim me Declan O'Mahony, Drejtues i ekipit		John J Ryan	

			dhe Dule Visovac Zëvendës- drejtues i ekipit i projektit të financuar nga BE- ja për mbështetje të mëtejme për refugjatët dhe personat e zhvendosur në Serbi			
25.	22/12/16	Hotel Sirius	Tryezë e ekspertëve, Fushata Drejtësia dhe njerëzit		Noora Aarnio dhe Kushtrim Xhaferi	